

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri**

**Ndërtimi me profile:**

***“Strukturë”***

***“Gjeoteknikë”***

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Ass. Dr. Florim GRAJÇEVCI

Dr. Endrit TUZI



Shkurt 2018

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile:**

- **Strukturë;**
- **Gjeoteknikë**

<b>Tabela e të dhënave për programin e studimit</b>		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "POLIS"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Arkitektures dhe Dizajn
3	Njësia Bazë:	Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri
4	Urdhri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 62, date 29.06.2015 Urdhri nr. 432, date 12.11.2015
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi me profile: a. Strukturë; b. Gjeoteknikë
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera	Vetëm nga UPOLIS
12	Diploma që lëshohet	Diplome Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile: "Strukture" dhe "Gjeoteknike"
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
17	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	Ne vazhdim. Diplomantet e pare ne vitin 2018.
18	Numri total i studenteve për program	56

## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile Strukturë dhe Gjeoteknikë**

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile Strukturë dhe Gjeoteknikë i Universitetit "POLIS" ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, përkatësisht Departamenti Arkitekturës dhe Inxhinierisë.

Në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 për arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimi nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 62 të datës 29.06.2015, Vlerëson në pozitiv hapjen e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë", të Universitetit "POLIS".

Programi i Studimit Master Shkencor në "Inxhinieri Ndërtimi" është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 432, datë 12.11.2015, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor" pranë fakultetit "Arkitekturë dhe Dizajn". (Aneks 2, Urdhër hapje)

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit, Vendim të Senatit Akademik dhe miratim të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit programi Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, është i organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, dhe 120 ECTS ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Ass. Dr. Florim Grajcevci
2. Dr. Endrit Tuzi

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxher teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, Renata Qatipi.

Më datë 15.02.2018 Universiteti POLIS është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi, nëpërmjet sistemit AMS. Me shkresë Nr. 20/3 Prot., datë 16.02.2018 "Dërgohet Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm", Draft RVJ është dërguar zyrtarisht.

Universiteti POLIS ka sjellë përgjigje me shkresë Nr. 169/18, datë 19.02.2018 "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit MSc. Inxhinieri Ndërtimi", duke u shprehur që "nuk ka asnjë koment lidhur me Draft RVJ".

Pas përgjigjes, Raporti mori formën e tij përfundimtare.

### **1. Misioni/Objektivat e programit të studimit**

#### **Pjesa përshkimore**

Programi i Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" është aktivizuar duke regjistruar studentët e parë në këtë program në vitin akademik 2016-2017.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm citohet:

Qëllimi i Programit të Studimit është që të përgatisë studentët profesionalisht si Inxhinierë Ndërtimi në profilet Gjeoteknikë dhe Strukturë me mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik. Ky program studimi i ciklit të dytë mund të konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë të atyre programeve të cilët japin formime me bazë të gjerë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Ndarja e studimeve në dy profilet përkatëse si Gjeoteknikë dhe Strukturë synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë.

Programi i ofron studentëve mundësinë për t'iu përshtatur ndryshimeve teknologjike dhe ti bëjë ato të konkurrojnë si brenda tregut vendas ashtu dhe në nivel ndërkombëtar. Inxhinierët janë një figurë qendrore dhe përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e një gamë të gjerë të projekteve të infrastrukturës. Vetë tregu dhe kriza që e ka përfshirë në këtë çast përbën një sfidë mjaft komplekse për gjetjen e zgjidhjeve të reja dhe efektive, si në një kontekst ekonomik ashtu dhe atë shoqëror e teknologjik e mjedisor. Ky program synon të sigurojë studentët me aftësitë e duhura teknike dhe të menaxhimit të procesit të ndërtimit në mënyrë efektive për të kontribuar në këtë mjedis dhe të përgatisë studentët për karrierën e tyre si inxhinier por dhe si kërkues të ardhshëm.

Falë dhe veçorive dhe karakteristikave të programeve të tjera të studimit të Universitetit POLIS, ky program i ri jo vetëm që plotëson më së miri spektrin e këtyre programeve me fokus mjedisin e ndërtuar por integrohet më së miri me to duke simuluar kushtet e një mjedisi pune real dhe shumëdisiplinor dhe duke marrë nga sensi praktik i përdorimit të skenarëve reale për të zgjidhur dhe për të aplikuar teknikat dhe zgjidhjet e duhura për problemet inxhinierike duke bashkëpunuar me studentë nga programet e tjera të lidhura me fushën e ndërtimit, por dhe duke qenë pjesë e vazhdimit të studimeve për studentët që përfundojnë studimet në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.

Nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion dhe nga RVB, disa nga objektivat kryesore të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" janë:

1. Të aftësojë studentët në njohjen e historisë, koncepteve, dijeve dhe praktikave shkencore inxhinierike dhe të zhvillojnë një aftësi për të vlerësuar dhe për të interpretuar problemet inxhinierike.
2. T'u sigurojë studentëve njohurive themelore dhe të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve inxhinierike në lidhje me profilet e Gjeoteknikës dhe Strukturës.
3. Të përgatisë studentët me aspektet teorike jo vetëm në fushën teknike por dhe në ato të menaxhimit dhe të qëndrueshmërisë.
4. Të përgatisë studentët me një qasje efektive në një mjedis shumëdisiplinor dhe praktik të fushës së ndërtimit.
5. Të fitojnë njohuritë dhe aftësitë për punësim në sektorin publik dhe privat të lidhur me fushën e ndërtimit.
6. Të sigurojë një sfond shkencor për studime ose kërkime të mëtejshme.
7. Të aftësojë studentët me njohuritë bazë të komunikimit me shkrim dhe verbal, të nevojshme për një karrierë të suksesshme profesionale.
8. Të njohë studentët me çështje e etikës profesionale, sigurisë si dhe impaktin shoqëror të kësaj disipline.
9. Të hapë horizonte të reja për këtë profesion në Shqipëri si restaurimi i trashëgimisë kulturore, projektimi i qëndrueshëm, dizajni parametrik, dizajni estetik strukturor, etj.

Grupi i jashtëm i vlerësimit konstaton se Misioni i Institucionit është në përputhje me programin e studimit, ndërsa objektivat e programit të studimit përputhen me kurrikulën si dhe lëndët/modulet e programit të studimit për Inxhinieri Ndërtimi, profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë.

Gjithashtu GVJ gjykon se misioni dhe objektivat janë hartuar në përputhje me llojin dhe nivelin e programit të studimit në fjalë, duke i mundësuar studentëve njohuri të thelluara teorike dhe veçanërisht aftësi praktike për të garantuar një karrierë të suksesshme në organizma si të sektorit privat ashtu edhe atij publik.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (<i>Rregullorja e programit</i>) dhe (<i>Statuti i Universitetit POLIS</i>), u konstatua se Programi Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Ndërtimi</i>", me profile "<i>Strukturë</i>" dhe "<i>Gjeoteknikë</i>", të Universitetit "POLIS", është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të parashikuara këto dy të fundit në nenet 2 dhe 3 të Statutit të U_POLIS.</p> <p>Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të U_POLIS hartimi dhe përditësimi i programit Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Ndërtimi</i>", me profile "<i>Strukturë</i>" dhe "<i>Gjeoteknikë</i>" është realizuar sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë qëllim në RVB por edhe gjatë vizitës u konstatua se U_POLIS mban lidhje të ngushta me sektorët e punësimit (sektori privat, bashkitë, komunat e deri tek qarku e rajonet, institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja) që kanë fokus kryesor fushën e ndërtimeve për të siguruar përputhshmërinë e programit të studimeve me nevojat e tregut.</p> <p>Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund ti shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Kjo jo vetëm që bëhej e mundur me studime të mirëfillta duke marrë mendimin e kompanive, institucioneve të cilat kanë një kërkesë për këta lloj studentësh por dhe duke u bazuar në Agjendës së Kërkimit Shkencor, të U_POLIS e cila përcakton fushat prioritare ku institucioni ushtron aktivitetin e tij.</p> <p>Programi Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Ndërtimi</i>", me profile "<i>Strukturë</i>" dhe "<i>Gjeoteknikë</i>" ka synim për të transformuar pozitivisht shoqërinë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm duke influencuar politikën publike ku është përfshirë me ekspertizë dhe punë të stafit e studentëve në një sërë reformash madhore si ajo territoriale e administrative, ajo e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, si dhe reforma e arsimit të lartë.</p>

<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" është pjesë integrale e zbatimit të misionit që ka institucioni, dhe ka objektivat për edukimin e inxhinierëve duke u mbështetur në arritjet më të fundit shkencore në inxhinierinë e ndërtimit dhe në të njëjtën kohë duke shtuar kompetenca më të veçanta për studentët me njohurit e përgjithshme që lidhen me multi disiplinat dhe kompleksitetet e fushave të ndërtimeve, e që për arritjet e tyre nevojitet bashkëpunimi me shumë disiplina.</p> <p>Kjo mund të zërthehet që, pas përfundimit të studimeve studenti do të ketë mundësi ti shohë objektet në një aspekt më të gjerë jo vetëm strukturor funksional apo edhe atë estetik.</p>
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajta e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky program është ndërtuar në respekt dhe zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë në Inxhinieri Ndërtimi përkon me Nivelin e 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>U_POLIS ka një plan strategjik në nivel institucioni të miratuar me Vendim nga Senati Akademik Nr.1 datë 7 25.09.2014, mbi të cilin është mbështetur dhe zhvillimi i institucionit, ku shpjegohet misioni dhe vizioni si dhe objektivat afatmesme dhe afatgjata të institucionit.</p> <p>Universiteti POLIS i ka kushtuar një vëmendje të veçantë realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe të nxënit, si komponenti bazë për konsolidimin e institucionit, me synimin për t'u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus të mirë përcaktuar dhe që ofron një shërbim cilësor për studentët.</p> <p>Për përmirësimin e procesit të mësimdhënies universiteti ka një metodologji shumë të qartë vlerësimi.</p> <p>1. Vlerësimi i procesit mësimor nëpërmjet formularëve për performancën e pedagogut. Ky proces realizohej nga katër komponentë:</p> <p>1.1 Vlerësimi i pedagogut nga studenti;</p>

1.2 Vlerësimi i kolegut nga kolegu;

1.3 Vetëvlerësimi;

1.4 Vlerësimi nga eprori.

2. Vlerësimi i stafit akademik bazuar në aktivitetin e tyre kërkimor shkencor.

3. Mobiliteti i stafit akademik por edhe atij administrativ nëpërmjet projekteve të ndryshme Erasmus+, kjo mënyrë operimi bën të mundur përfitimin e eksperiencave të rreja, në mësimdhënie por dhe në procesin kërkimor të stafit dhe studentëve.

Mënyra e menaxhimit të programit është rregulluar në përputhje me Ligjin e Ri të Arsimit 80/2015, ku duke filluar nga viti akademik 2016-2015, programi ofrohet në nivel departamenti. Konkretisht nga departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri. Parë në këndvështrimin menaxherial kjo dashje pa dashje ndikon në përmirësimin e cilësisë, krahasuar me atë mënyrë që ka qenë më parë kur programet ofroheshin në nivel fakulteti.

U\_POLIS ka një plan strategjik në nivel institucioni të miratuar me Vendim nga Senati Akademik Nr.1 datë 7 25.09.2014, mbi të cilin është mbështetur dhe zhvillimi i institucionit, ku shpjegohet misioni dhe vizioni si dhe objektivat afatmesme dhe afatgjata të institucionit.

Universiteti POLIS i ka kushtuar një vëmendje të veçantë realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe të nxënies, si komponenti bazë për konsolidimin e institucionit, me synimin për t'u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus të mirë përcaktuar dhe që ofron një shërbim cilësor për studentët.

Programet e studimeve të Institucionit vazhdimisht marrin informata kthyes nga ish student të diplomuar, përmes rrjetit ALUMNI, në të cilat vijnë sugjerimet, si dhe nga partnerët ndërkombëtar, grupeve të vlerësimeve përmes të cilëve ekuilibrohen treguesit e matshëm të vlerave të programeve, nevojave të freskimit të tyre, plotësime dhe ndryshime eventuale.

Cilësia e mësimdhënies është objektivi kryesor përmes të cilës Institucioni synon vlerat maksimale të nxënies. Institucioni ka sistem të ngritur të kontrollit permanent të cilësive të mësimdhënies duke përmes pyetësorëve periodik të vlerësimit të pedagogëve të angazhuar. Ky vlerësim bëhet nga ana e Studentëve, kolegëve dhe vetëvlerësimi. Institucioni ka të ngritur NJBSC e cila me punën e sajë dëshmon për sistemin e kontrollit të cilësive të mësimdhënies dhe rezultatet e nxënies të Studentëve.

Vlerat dhe cilësitë e mësimdhënies reflektojnë direkt te studenti dhe performanca e tij si dhe arritja e rezultateve nxënëse duke plotësuar kompetencat nga objektivat e



	<p>Institucionit.</p> <p>Mësimdhënësve ju mundësohet që të përgatiten dhe të marrin informacionet më të reja të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo ndihmë ju ofrohet përmes punës ndëraktive të personelit Akademik të institucionit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p><b>Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë", përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit.</b></p> <p><b>GVJ konfirmon se Universiteti POLIS, ka një strategji të zhvillimit e vlefshme kjo për periudhën 2014-2020, e hartuar me profesionalizëm duke përfshirë çdo fushë e cila ka të bëjë me zhvillimin akademik, mësimor, shkencor të një institucioni. Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS.</b></p> <p><b>Rezultoni se institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, si komponent bazë për konsolidimin e institucionit me synimin për t`u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus mirë përcaktuar dhe që i ofron studentëve një shërbim cilësor.</b></p> <p><b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të parë "Misioni/Objektivat e programit të studimit" janë plotësuar.</b></p>	

## **2. Struktura akademike e Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe Departamentit përgjegjës për programin e studimit**

### **Pjesa përshkrimore**

Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit është njësi kryesore brenda së cilit është vendosur dhe menaxhohet Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë". Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Autoriteti drejtues i tij është Dekani.

Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është **Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri**. Autoriteti drejtues i tij është Përgjegjësi i Departamentit. Veprimtaria, programet dhe projektet me të cilat punojnë departamentet miratohen nga Senati akademik.

**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE DIZAJNIT** përbehet nga:

- 1) Departamenti Art dhe Dizajn**
- 2) Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri**
- 3) Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn**

Grupi i vlerësimit të jashtëm mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar së bashku me RVB si dhe në bisedat me stafin dhe dokumentet e vëna në dispozicion gjatë vizitës së kryer pranë ambienteve të Universitetit POLIS, konstatoi se të treja njësitë bazë të fakultetit Departamentet si dhe Qendra



Kërkimore kanë në përbërje të tyre staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Secila njësi bazë plotëson kushtet e përcaktuar nga ligji ku minimumi tre pjesëtarë të stafit akademik të jenë me gradën shkencore "Doktor".

Gjithashtu u konstatua se profili i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet më së miri me programin Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë". Kjo ndikon në përmbushjen e standardeve të programit.

Gjithashtu vihet re se edhe stafi i cili është angazhuar me kohë të pjesshme është një staf i kualifikuar dhe profesionist në fushën që mbulon. Kjo bën të mundur ofrimin e një aspekti praktik dhe konkret të organizimit të programit.

Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Në departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë Personeli Akademik i angazhuar përbëhet prej 18 pedagogesh nga të cilët 14 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 4 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raportet mes Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë  $14/4=3.5$ , ose 78 % janë PAE ndërsa 22 % janë PAK.

Personelin Akademik Efektiv e përbejnë 2 Profesor, 1 Profesor te Asocuar, 2 pedagog me gradën Docent, 6 pedagog doktorantë dhe 3 pedagog me PhD ne proces dhe me specialitet post Master (MSc ose MA).

Personeli Administrativ është i përberë nga 10 veta. Raportet e Personelit Akademik ne nivel Departamenti Arkitekture dhe Inxhinieri me Personel Administrativ është  $(14+4)/10=1.8$ . Raporti Student me Personel Administrativ  $56/10$  rezulton 5.6 student/1 personel administrativ, (ku 56 është numri i studenteve ne total për dy vitet Akademike për 2016/2017 dhe 2017/2018).

Personeli Akademik ka ngarkese vjetore 24 deri 338 ore mësimore me një mesatare prej 160 orë vjetore. Ndërsa Programi i studimit për të dy profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë ka ngarkese vjetore ne total 1506 orë (Leksione, Seminare/Labororë, Ushtrime, Praktikë Profesionale, Kurse, studim i pavarur i studentit).

Për sa më lart shih në Aneks Tabelat 1, 2

### **Vlerësimi sipas standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë Universitetit POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Arkitekture dhe Dizajn, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>Institucioni ka në strukturën e tij akademikë tre fakultete, si dhe një qendër ndërdisiplinore e cila shërben për menaxhimin e informacionit dhe punëve kërkimore të tre qendrave kërkimore.</p> <p>Fakulteti Arkitekture dhe Dizajn përbëhet nga këto Departamente:</p>

	<p>1) Departamenti Art dhe Dizajn</p> <p>2) Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri</p> <p>3) Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn</p> <p>Departamentet/Qendrat si njësi bazë, të organizuara pranë Fakultetit Arkitekturë dhe Dizajn kanë në përbërje të tyre të paktën 7 anëtarë efektivë. Nga të cilët vlen të theksohet se, jo të paktën 3 por të paktën 4 prej tyre janë ma gradën shkencore “Doktor”. Kjo tregon përkushtimin e universitetit në rëndësinë që i jep rritjes së kapacitetit akademik të stafit të angazhuar në këtë program studimi.</p>
--	---

**Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në takimet me stafin dhe bazuar ne dokumentacionin përkatës (Statut dhe Rregullore e Përgjithshme) u konstatua se fakulteti përgjegjës Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn dhe Departamenti i cili merret me organizimin dhe menaxhimin e programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtim", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" janë plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programit dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive në dy vitet e veprimtarisë së programit të studimit.</p> <p>Vetë stafi demonstroi mënyrat e procesit të rekrutimit ku përfaqësues të fakultetit dhe departamentit përfshiheshin në mënyrë aktive në procesin e rekrutimit. Ky proces u verifikuar bazuar dhe ne dokumentacionin mbështetës që u pa në zyrën e Burimeve Njerëzore. Por jo vetëm pasi i gjithë procesi mbështetej në Rregulloren e Përgjithshme si dhe në Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Procedurën e Rekrutimit të stafit të U_POLIS.</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

**Institucioni organizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Kjo strukturë ka ardhur gjithmonë duke u përmirësuar me qëllim zbatimin e nevojave institucionale, kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë. Në përputhje dhe në përshtatje të Ligjit të Ri të Arsimit 80/2015, theksojmë se Universiteti POLIS, ka bërë një ri-shpërndarje të programeve pranë departamenteve, dhe kjo ka bërë të mundur që konkretisht Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë të marrë një rol më të madh dhe më të drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtim", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë".**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të dytë “Struktura akademike e Fakultetit përgjegjës” janë plotësuar.**

**Institucioni organizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Kjo strukturë ka ardhur gjithmonë duke u përmirësuar me qëllim zbatimin e nevojave institucionale, kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë. Në përputhje dhe në përshtatje të Ligjit të Ri të Arsimit 80/2015, theksojmë se Universitetit POLIS, ka ri-organizuar shpërndarjen e programeve të studimit në njësitë bazë, kjo ka bërë të mundur që**

**departamentet dhe konkretisht Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë të marrë një rol më të madh dhe më të drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtim", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë".**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të dytë "Struktura akademike e Fakultetit përgjegjës" janë plotësuar.**

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Personeli Akademik ka ngarkese vjetore 24 deri 338 ore mësimore me një mesatare prej 160 orë vjetore. Ndërsa Programi i studimit për të dy profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë ka ngarkese vjetore ne total 1506 orë (Leksione, Seminare/Laboratorë, Ushtrime, Praktikë Profesionale, Kurse, studim i pavarur i studentit).

Stafi Akademik Efektiv përveç detyrimeve mësimore kanë angazhime edhe në fushat tjera sikur janë marrëdhëniet ndërkombëtare të institucionit përkatësisht të Universitetit POLIS, aktivitete lokale-vendore duke u përfshirë në projekte të ndryshme konkrete duke ndihmuar komunitetin dhe me kryesorja një pjesë e madhe Personelit Akademik Efektiv kohë të madhe ju dedikohet kërkimeve shkencore, pjesëmarrje ne konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Disa nga Personeli Akademik kanë angazhime edhe rreth menaxhimit të vetë Departamentit, Fakultetit përkatësisht Universitetit duke qenë koordinatorë të programeve, udhëheqës të Departamenteve, komisioneve brenda njësisive Akademike etj.

Për rekrutimin e Personelit Akademik nga Universiteti POLIS ekzistojnë procedura ligjore, transparente, të cilat realizohet edhe përmes detyrave kontraktuale për secilin person, ndërsa metodikat didaktike në shumë raste freskohen (përmirësohen) forcohen me metoda të avancuara të dhënies së mësim, vlerësimit, përmes takimeve brenda Fakultetit dhe Personelit Akademik.

Për rastet e përcaktimit të detyrave të personelit për profilin e propozuar nga Departamenti bazohen në përmbajtjen e lëndës që do të ofrojë Pedagogu, natyrën e mësimdhënies dhe performancën e njohurive dhe aftësive të cilat transferohen te Studentët.

Nga vizita në Institucion konstatuam se i gjithë dokumentacioni lidhur me Personelin Akademik Efektiv dhe të jashtëm ishte i plotë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit**

Metodat Didaktike të aplikuara në Departamentin e Arkitekturës Inxhinierike - profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë, të gjetura gjatë vizitës dhe takimeve me Personelin Akademik dhe Studentet mund të numërohen nga: asnjë vonesë e personelit Akademik në mësim. Secili Pedagog në fillim të semestrit gjatë orëve të para prezanton në mënyre të hapur Syllabusin e lëndës me përmbajtjen e lëndës, objektivat e lëndës si dhe vëllimin e punës të lëndës të shtrirë gjatë kohës prej 14 ose 15 javësh.

Studentët njoftohen me arritjet bashkëkohore të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimeve. Bëhet ndërlidhja e punës me profileve të afërta të inxhinierisë së Ndërtimit sikur janë Arkitektët Inxhinierët e Eficiencës së Energjisë përmes hartimit të projekteve të përbashkëta me punë në grupe, prezantime individuale.

Gjatë punës së mësimdhënësve me Studentët përdoren metodat dhe teknikat më të avancuara të mësimdhënies duke filluar nga ambientet shumë komode të Universitetit, pajisjeve konkrete të aplikueshme në profesion si modele të krijuara nga vet Studentët në bashkëpunim me Stafin Akademik.

Në takimet me Studentët vërehej puna kreative e mësimdhënësve duke i frymëzuar Studentët për studime më të thella shkencore, ofrimi i literaturave bashkëkohore aktuale në fushën e Inxhinierisë Dhe e gjitha kjo si rezultat i mjeteve Didaktike të përdoruar Pedagog-Student. Ndërsa, mungesa e literaturave dhe botimeve bashkëkohore në gjuhën shqipe është e mangët duke pasqyruar faktin që zhvillimi shkencor dhe botimet në këto fusha shkencore në nivel ndërkombëtar janë të mëdha, prandaj për t'i kapë këtë trendë është e vështirë.

Mjetet Didaktike të përdorura për të fituar cilësi të produktit janë mësimdhënia, ushtrimet numerike, studiot, prezantimet, vizitat në kantiere ndërtimi, praktika profesionale, hulumtimet përmes literaturave dhe të tjera.

**Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/ gradat, (Tabelat 3, 4, 5 dhe 6, të cilat janë plotësuar nga verifikimi i tabelave të pasqyruara në RVB)**

Të dhënat e detajuara për stafin akademik që mbështet programin e studimit janë dhënë në Aneks, Tabela 3, 4, 5 dhe 6

Për vitin akademik 2016-2017 raporti rezulton 13 PAE/4 PAK (76.47% / 23.53%)

Për vitin akademik 2017-2018 raporti rezulton 14 PAE/4 PAK (77.78% / 22.22%)

Raporti në mes të Personelit Akademik dhe Studenteve  $22/56=0.393$  ose 2.55 student për një Personel Akademik që është tregues i mirë i performancës të Institucionit, përkatësisht Departamentit.

**Të dhënat sipas kualifikimit, kontratës dhe Raportet midis tyre (Tabela 4)**

Raporti i Personelit Akademik Efektiv me gradat e tyre si dhe të Personelit Akademik me kontratë është dhënë në tabelën 4, dhe gradat e personelit akademik janë më shumë se Doktor i shkencave.

**Të dhënat sipas seksit (Tabela 5) dhe të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 6)**

Sipas seksit në këtë departament aktivizohen 9 pedagogë të gjinisë femërore dhe raporti është 9/18 që i bie të jetë 50% femra dhe 50% meshkuj.

**Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 7)**

Në momentin e aplikimit për përgatitjen e dosjes për licencimin e programit ka funksionuar një Këshilli Shkencor i Programit MSc në Inxhinieri Ndërtimi (shih Tabelën). Ky organ që ka funksionuar vetëm gjatë procesit të ngritjes së programit. Me marrjen e licencimit ky organ pushoi së ekzistuari. Ky këshill ka patur si detyre hartimin e kurrikulave, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe fizike.

Tabela 7

<b>Emër Mbiemër</b>	<b>Titulli/ grada</b>	<b>Pozicioni në Këshillin shkencor</b>
Luljeta Bozo	Prof. Dr.	Kryetar
Diana Haxhihyseni	Prof. Ass	Nënkryetar
Merita Guri	Doc. Dr	Nënkryetar
Egla Luca	Dr	Përgjegjës për hartimin e programit të profilit “Strukturë”
Erdi Myftaraga	MSc	Përgjegjës për hartimin e programit të profilit “Gjeoteknikë”

Koordinator për programin e studimit; Dr. Egla Luca.

**Kontratrat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

I gjithë stafi Akademik si dhe Personeli Administrativ i Angazhuar ne Universitetin POLIS kalojnë nëpër procedurat e rekrutimit të cilat janë pjesë e statutit të Universitetit si dhe rregulloreve tjera te miratuara nga Senati i Universitetit ne pajtim me legjislaturën ne nivel te Shtetit.

Procedurat e pranimit te Personelit Akademik janë: bëhet njoftimi nëpër mediat sociale si dhe ne web faqen e universitetit POLIS lidhur me konkursin për nevojat e personelit. Nga te interesuarit janë format teknike dhe kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për konkurrim. Bëhet rangimi i kandidatëve potencial të mundshëm për pranim dhe ju caktohet koha për intervista. Pas intervistave bëhet vlerësimi i secilit kandidat për kriteret e veçanta dhe më pastaj bëhet përzgjedhja e kandidatit.

Kandidati i zgjedhur nënshkruan kontratën në të cilën përshkruhen detyrimet, të drejtat e tyre, shpërblimet financiare, ngarkesa mujore si dhe kërkesat më specifike.

Kontrata e punës përmban detyrimet, detyrat dhe të drejtat e çdo personi që rekrutohet. Ajo është mjaft e detajuar dhe e plotë.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

Stafi Administrativ i Universitetit POLIS ka detyrat e veta të specifikuar në kontrata individuale. Sipas Organogramës administrata ndahet në njësitë: Burimet njerëzore & Çështjet Juridike - Protokoll, Administrimi i Procesit Mësimor & Sekretaria Mësimore, dhe Financa, Shërbime, Administrim.

Mbajtja e shënimeve realizohet sipas ligjeve ne nivel Shteti. Efikasiteti i shërbimeve është jashtëzakonisht i shpejtë dhe cilësor ndërsa siguria e të dhënave është në nivel shumë të mirë.

Stafi ndihmës është me diplomë BSc dhe MSc.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Nga vizita në Institucion u njohëm me të gjithë dokumentacionin që i takon kësaj pike dhe konstatojmë se në to nuk ka ndryshime dhe si të tilla ato përmbushin standardet që lidhen me këta tregues.

Dokumentacionet e kërkuara gjatë vizitës në institucion për qëllim të vetëm: sigurimi i cilësisë së informatës, vijueshmërisë së aktivitetit si dhe dëshmi për deklaratimet janë përzgjedhur si dokumentacione:

- Struktura Organizative;
- Modeli i Diplomës për dy profilet,
- Shembuj të vlerësimit të pedagogëve,

- Suplementi i diplomes MSc për dy profilet,
- Sistemi i pikësimit,
- numrat e regjistrave të diplomave.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit për departamentin e Arkitekturë dhe Inxhinieri - profilet Strukture dhe Gjeoteknikë të hartuara nga IAL realizohen nëpërmjet shërbimeve Administrative si dhe personelit Akademik të angazhuar.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.</p> <p>Angazhimi i Personelit Akademik në arritjen e Objektivave nga Kurrikula bëhet përmes lëndëve dhe moduleve si dhe syllabuseve të tyre. Në secilin syllabus janë të specifikuara objektivat e lëndës që shkojnë paralel me objektivat e përgjithshme.</p> <p>Objektivi kryesorë i programit të studimit duke qenë që është të përgatisë Studentin profesionalisht si Inxhinier Ndërtimi në profilet Strukturë ose Gjeoteknikë realizohen duke u mbështetur në nivelin e përgatitjes së Studenteve të cilët vijnë nga cikli i parë i studimeve me kompetenca të mjaftuara (studimet bachelor) për të arritur nivel më të lartë të kompetencave në fushat më të gjëra të Inxhinierisë së Ndërtimit përmes Lëndëve dhe moduleve teorike, ushtrimeve numerike, Laboratorëve, punës praktike, vizitave në kantiere si dhe një mori aktiviteteve tjera që çojnë drejt arritjes së këtij qëllimi të përgjithshëm.</p> <p>Stafi Administrativ, dhe Menaxherial i Fakultetit, përkatësisht Universitetit angazhohen në maksimum që Studentëve të ju ofrohen shërbime cilësore, në kuptimin e shpejtësisë, saktësisë dhe sigurisë. Të gjitha këto shërbime janë paketë shërbimi që prodhojnë cilësi duke numëruar infrastrukturën e Fakultetit, shërbimet e informacioneve, kontratat, Bibliotekën etj..</p> <p>Strategjia e programit është paralel me Strategjinë e IAL duke u mbështetur në "Vizioni i Universitetit POLIS është të ofrojë ekselencë në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij".</p> <p>Institucioni ka të gjithë dokumentacionin lidhur me rekrutimin e personelit Akademik dhe Administrativ.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ne kuadër të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit është ngritur grupi punues i emëruar si "Këshilli Shkencor i Programit të Studimit për Struktura dhe Gjeoteknike". Ky Këshill ka hartuar kurrikulën e profileve deri në marrjen e vendimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit për hapjen e tyre. Me pas ky Këshill ka pushuar se funksionuari.</p> <p>Si nevojë e funksionimit të drejtë të programit IAL ka udhëheqësin dhe koordinatorin e programit studimor me qëllim funksionimin e drejtë të programit.</p> <p>Koordinatori i programit kujdeset se bashku me stafin Akademik dhe Administrativ që të freskojë kurrikulën dhe të organizojë programin e studimit. Nga viti i parë i studimeve janë bërë ndryshime në vitin e dytë (jo më shumë se 20%) me qëllim të arritjes së objektivave në mënyrë sa më të përsosur duke ndërruar ose shtuar lende dhe module studimi.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi është shtytësi kryesor që çon më tej përmbushjen e Objektivave kryesore dhe të veçanta. Në çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lende në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosen rezultatet e nxënies.</p> <p>Rekrutimi i personelit Akademik dhe Administrativ realizohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke dëshmuar me kontrata të rregullta pune për stafin Akademik (Efektiv ose me Kontrate) si dhe për Administratën, duke vlerësuar edhe peshën e tyre kohore dhe detyrimet dhe obligimet kontraktuale. Ato janë shumë të rregullta, të rinovueshme për personelin me kontratë pune dhe azhurnohen kohë pas kohe.</p>
--	---

**Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Proceduarat ligjore për rekrutimin e personelit Akademik janë në përputhje ligjore duke përshkruar se Institucioni bënë shpalljen publike të njoftimit për punësim në rrjetet sociale si dhe web faqen e Universitetit POLIS dhe se ekziston rregullorja për rekrutimin e personelit.</p> <p>Dhe institucioni ka të sanksionuar në rregullore kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Në të përcaktohen kriteret të përgjithshme si dhe specifike rast pas rasti, sipas fushës akademike të ekspertizës që kërkohet.</p> <p>Parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Përgjithshme,</p> <p>Është në interesin më të mirë të institucionit rekrutimi i një stafi të aftë profesional dhe të kualifikuar prandaj dhe kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurrim të hapur duke ndjekur hapat e mëposhtëm:</p>
---	---



- ✓ Departamenti dhe Fakulteti nxjerr nevojat për staf të ri duke bërë publike vendet e lira si dhe kriteret dhe kërkesat specifike për plotësimin e tyre;
- ✓ Njoftimi vendoset në faqen elektronike të institucionit si dhe vihet në dijeni Shërbimi Kombëtar i Punës.
- ✓ Kandidatët paraqesin CV e shoqëruar me dokumentet e nevojshme pranë institucionit;
- ✓ Realizimi i intervistave të punës sipas datave të përcaktuara nga rektorati. Në rastin e stafit me eksperiencë të pakët mësimdhënëse, kandidatit/kandidates i kërkohet të zhvillojë një orë mësimi dhe gjithashtu të prezantoj punët e veta kërkimore dhe shkencore. Ky është mjete më i vlefshëm për të parë cilësitë e aplikantëve kandidat për staf akademik;
- ✓ Shpallja e kandidatit fitues dhe kontaktimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore për njohjen e dokumentacionit të nevojshëm për punësim si dhe lidhja e kontratës së punës.

Kandidati i zgjedhur nënshkruan kontratën në të cilën përshkruhen detyrimet, të drejtat e tyre, shpërblimet financiare, ngarkesa mujore si dhe kërkesat më specifike.

Në programin e studimeve në fjalë, për vitin akademik 2017/2018 Raporti i Stafit Akademik Efektiv me Stafin Akademik të angazhuar është 77.78% me 22.2% (14 Efektivë/4 me kontrate).

Gjatë vizitës në Institucion vërtetimi i procedurave për mënyrën e zgjedhjes ka qenë në vlerësimin e ekzemplarëve të rastësishëm dhe kemi gjetur se vlerësimi i stafit Akademik ka qenë transparent, i paanshëm dhe ka siguruar cilësi në arritjen e Objektivave.

Përqindja e ngarkesës së pedagogëve me kohë të plotë kundrejt atyre me kontratë përbën 91% orëve totale në auditor.

Administrata e Universitetit është e rregullt në mbajtjen e datotekës së përgjithshme të të punësuarve në Institucion. Shënimet janë vërtetuar nga rasti në rast.

Rekrutimi i Personelit Akademik është transparente dhe zhvillojnë këtë procedure administrative: bëhet njoftimi nëpër mediat sociale si dhe në web faqen e universitetit POLIS lidhur me konkursin për nevojat e personelit.

Nga të interesuarit janë format teknike dhe kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për konkurrim.

Bëhet radhitja e kandidatëve potencial të mundshëm për pranim dhe ju caktohet koha për intervista.

Pas intervistave bëhet vlerësimi i secilit kandidat për kriteret e veçanta dhe më pastaj bëhet përzgjedhja e kandidatit

**Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.**

**Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjës për programin e studimeve Master Shkencor për Inxhinierinë e Ndërtimit profili Strukturë dhe Gjeoteknikë është Docent Dr. Arben Shtylla, ndërsa koordinatore e programit është PhD Egla Luca.

Në matricën e lëndëve të cilat zhvillohen të gjithë bartësit e lëndëve janë me gradë shkencore Doktor.

I gjithë stafi menaxherial i Institucionit i cili udhëhiqet nga Rektori, zv Rektori, Dekanët, zv. Dekan, shefat e departamenteve, koordinatorët e programeve janë të punësuar me kohë të plotë.

Praktikat Profesionale që zhvillojnë Studentët në këto dy profile kanë program pune dhe i nënshtrohen kontrolleve.

Një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e programit të studimit kryen edhe zyra për mbështetje dhe këshillim karriere.

Krahas rolit të kësaj zyre në mirëpritjen dhe orientimin e studentëve, zyra në fjalë së bashku me departamentin përcaktojnë institucionet ku do të zhvillohet praktika profesionale dhe caktojnë një staf Akademik cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës. Vlerësimi i studentëve për praktikën profesionale bëhet nga një komision vlerësues.

Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë të studimeve përkatësisht në semestrin e fundit. Kompania ku Studenti vijon praktiken profesionale, eprori i emëruar i sajë jep një vlerësim për Studentin dhe më pas kjo miratohet me konfirmim nga Dekani.

Pas përfundimit të praktikës, Studenti fiton 6 ECTS dhe nuk vlerësohet me notë (6 ECTS nuk hynë në notën përfundimtare të studimeve). Totali i orëve të punës në praktikë duhet të përmbajë 120 orë. Sipas Bolonjës të gjitha lëndët/modulet (kreditë e fituara) duhet të jetë të vlerësuara me notë, prandaj Institucioni rekomandohet që praktikën profesionale të e vlerësoj me notë.

Praktikat profesionale zhvillohen kryesisht pranë kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Ky proces menaxhohet me efektivitet.

Në rast se studentët zgjedhin të zhvillojnë praktikën pranë ndonjë institucioni tjetër, atëherë departamenti në bashkëpunim me zyrën për mbështetje dhe këshillim karriere merr informacion paraprak dhe më pas vlerëson nëse praktika mund të zhvillohet apo jo pranë këtij institucioni, për të siguruar një praktikë sa më të sigurt dhe efektive.

**Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për**

<b>tezën.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Temat e diplomave në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi zhvillohen gjatë gjithë vitit të fundit të studimit në trajtë studio.</p> <p>Një ditë në javë ju dedikohet vetëm procesit të diplomimit. Në fakt është caktuar që çdo enjte të jetë ditë pune me grupin e diplomantëve dhe me mësimdhënësit duke bërë prezantim dhe duke vlerësuar progresin e punës së diplomës për secilin kandidat në mënyrë hap pas hapi.</p> <p>Ky proces mbështetet edhe nga lënda “Metoda Kërkimore” që kristalizon akoma më shumë të gjithë procesin e kërkimit shkencor të studentëve. Raporti pedagog student për ndjekjen e temave të diplomave në çdo rast është më i ulët se 1 me 5, ndërsa secili Student ka një temë dhe një mentor.</p> <p>Në programin e studimit staf akademik janë 7 titullarë lëndësh/modulesh që kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”, përkatësisht:</p> <p>Prof. Dr. L. Bozo, Prof. Dr. Gj. Ikonomi, Doc. Dr. A. Shtylla, Doc. Dr. M. Guri, Dr. E. Luca, Dr. E. Dobjani, Dr. S. Sukaj, si dhe 3 asistente që janë në PhD proces, si mbështetje.</p> <p>Ne vitin e dytë janë gjithsej 20 studentë.</p> <p>Për profilin Gjeoteknikë studentët për ndjekje ndahen ndërmjet Prof. Dr. L. Bozo, Prof. Dr. Gj. Ikonomi dhe PhD proces Ilda Rusi si mbështetëse.</p> <p>Ndërkohë në profilin Strukturë, ndjekja e temave të diplomave ndahet ndërmjet Doc. Dr. A. Shtylla, Doc. Dr. M. Guri, Dr. E. Luca, Dr. E. Dobjani, Dr. S. Sukaj PhD proces Agulien Marku dhe Gerdi Papa si mbështetje.</p>
<b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Stafi Akademik i angazhuar (Efektiv apo part time) ka përgatitje profesionale të fushave përkatësisht disiplinave shkencore që i takojnë shkencës së Strukturave dhe Gjeoteknikës (Lëndët/modulet profesionale).</p> <p>Kompetencat e stafit Akademik sidomos në fushat e ngushta profesionale ju ofrojnë Studentëve Qasje dhe Rezultate të nxënies bashkëkohore në: Projektimin e Strukturave, Konstruksionet Gjeoteknike, Konstruksioneve /objekteve Hidroteknike, Mbikëqyrje profesionale, Menaxhim në Ndërtim, Teori të avancuara të Strukturave, verifikim të strukturave ekzistuese etj.</p> <p>Gjithashtu dhe Udhëheqësit e Universitetit, Fakultetit, Departamentit dhe Qendrave të kërkimit janë të fushave Arkitektonike dhe Inxhinierike të cilat fusha janë të shtrira edhe në Objektivat e profileve si dhe në Misionin e Institucionit.</p>

	<p>Në fillim të vitit të dytë të studimeve në dy profilet (Strukturë dhe Gjeoteknikë) Studentëve ju ofrohen orientimet e temave të mundshme për diplomë.</p> <p>Fushat e diskutuara me ta janë: Riparimi (<i>Retrofits</i>) i Strukturave ekzistuese, Projektim Strukturor sipas kodeve Shqiptare dhe Standardeve Evropiane, Projektim Infrastruktura, Eficienca dhe Riparimi Energjik, Mbrojtja ndaj Fenomeneve (<i>Hazards</i>) Natyrore (zjarri, tërmetet, era, rrëshqitjet, erozioni, përmytjet), Analizat sizmike të Strukturave, Konstruksionet Hidroteknike, Projektimi parametrik i Strukturave, Gjeoteknika - veprat mbajtëse ndaj erozionit, rrëshqitjet - Strukturat mbajtëse gjeoteknike në themelet e thella, Projektim me materiale jo konvencionale.</p> <p>Udhëheqësi i programit si dhe stafi Akademik ka njohuri të thella dhe të avancuara në fushat e sipërpërmendura dhe jo vetëm.</p> <p>Studentët gjatë gjithë kohës së studimeve përdorin edhe <i>software</i>-at profesional për llogaritje dhe projektim të strukturave (SAB, ETABS, CAD etj) të cilat ndihmojnë në rritjen e shpejtësisë së punimit të Diplomës dhe cilësisë së sajë.</p>
--	--

**Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka të zhvilluara aktivitetet shkencore, studimore, hulumtuese, të mbështetura në shumë faktor nga të cilët meritohet janë padyshim përveç personelit Akademik edhe pjesa tjetër e personelit që përcjell punën me Studentët. Dhe personeli tjetër ndihmës janë Laborantët që menaxhojnë me laboratorët dhe pajisjet e tyre, mirëmbajtësit e ambienteve shkollore (vlen për tu theksuar se pastërtia e ambienteve të mësimi, tualeteve, banjave, etj janë në nivel shumë të kënaqshëm). Udhëheqësit e bibliotekës, Co-Plani si studio projektimi. Vlen të theksohet se mungesa e Laboratorit për shqyrtimin e materialeve dhe konstruksioneve pran Institucioni konsiderohet si çështje e pa zgjidhur e programit të studimit. Studentëve ju ofrohet edhe zyra e IT-së e cila asiston në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p>Të gjitha këto shërbime që ju ofrohen Studentëve, kanë për qëllim që të jetë siguruar cilësia e mësimdhënies, dëshira për të studiuar thellësisht dhe arritja e kompetencave profesionale në nivelin çfarë kërkon tregu vendor dhe i jashtëm.</p>
---	---

**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e Gjeoteknikëi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Gjatë gjithë kohës (orarit të plot të punës) personeli Akademik si dhe Administrata janë prezentë në Fakultet. Ngarkesa e mësimdhënësit (varësisht nga natyra e Lëndës/ Modulit dhe Personelit Efektiv dhe Part time) sillen nga 24 orë mësimi deri në maksimum 338 orë mësimi. Vlera mesatare e ngarkesës së Personelit Akademik sillet rreth 160 orë vjetore e që është në përputhje me aktet nënligjore për aktivitetet dhe standardet mësimore të Personelit Akademik për këtë nivel të arsimit.</p> <p>Numri gjetur i Studentëve në dy vitet shkollore për dy profilet është 56. Raporti pedagog student është (56/18) 1/3.11 Pedagog për Student.</p> <p>Raporti ne mes te Personelit Akademik dhe Studenteve <math>22/56=0.393</math> ose 2.55 student për një Personel Akademik.</p>
--	---

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>IAL për të gjithë Personelin Akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, Efektiv apo me Kontratë të pjesshme dhe Personelin e Administratës, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike.</p> <p>Për çdo semestër përkatësisht vit akademik të ndarë sipas profileve Departamenti ka listën e plotë të stafit Akademik dhe personelit ndihmës në procesin mësimor. Kjo listë është e qasshme për Studentët në çfarëdo kohe që ata kanë nevojë.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit Akademik janë publike dhe kushdo që ka interesim për to mund të marr informatën nga mediat sociale si dhe nga web faqja elektronike e Institucionit.</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

**GVJ konstaton se Personeli Akademik dhe personeli mbështetës të angazhuar në mësimdhënie dhe në aktivitetet tjera përcjellëse për nevojat e IAL përkatësisht Studentëve janë të përgatitur profesionalisht dhe me gradë e cila kërkohet edhe nga standardet për Master i Shkencave dhe më specifikisht për profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë.**

**Ata rekrutohen me procedura të rregullta dhe transparente të cilat sigurojnë një cilësi të mirë për Studentët dhe Aktivitetet Akademike.**

**Administrata e Institucionit është profesionale, garanton shërbime të shpejta, cilësore, efikase dhe të sigurta. Nga vizita e bërë vërehen cilësi në shërbime, siguri të informacionit, pacenueshmëri të të dhënave personale të individëve dhe një hierarki të urdhrave dhe funksioneve respektuese.**

**Përveç angazhimeve mësimore Stafi Akademik ka detyrime edhe në fushën e kërkimeve shkencore si, pjesëmarrja në aktivitete hulumtuese dhe shërbimeve tjera profesionale, të cilat plotësojnë misionin dhe objektivat e Institucionit.**

**Praktika profesionale është një kompetencë përmes të cilës Studenti i ofrohet tregut të punës, duke ju dhënë rasti i qasjes te problemet në kantiere, krahasimi me pjesë teorike si**



dhe zgjidhja e tyre.

**Organizimi i temave të diplomave, puna intensive përmes takimeve të progreseve të tyre dëshmon punën dhe përkushtimin e Stafit të IAL për të arritur objektivat në kurrikulat mësimore dhe kompetencat te produkti i tyre.**

**GVJ konsideron se IAL plotëson kriteret në Standardet për Personelin Akademik dhe përcjellës në shkallën e kënaqshme për objektivat e parashtruara.**

**Ndërsa nga pikëpamja e menaxhimit (arkivimit-ruajtjes-sistemimit) të dokumentacionit, proceduarave të rekrutimit të Personelit dhe të dhënave për kualifikimin e Personelit Akademik çdo gjë është në rregull.**

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studimi dhe punë të pavarur të studentëve.

GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve të cilat përdoren për studentët. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së iri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuara.

Informacioni i plotë jepet në tabelën 8, ne Aneks

##### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijten e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>U_POLIS ka zhvilluar një formulë kreative partneriteti privat-privat për të mundësuar realizimin e një infrastrukture mësimore afatgjatë. Bordi Themelues i U_POLIS dhe Kler. Shpk kanë nënshkruar një marrëveshje ombrellë për zhvillimin e përbashkët të infrastrukturës me konceptin e bashkëpunimit për 99 vjet, e detajuar kjo më tej përmes një kontrate me të drejtë rinovimi çdo 10 vjet.</p> <p>Si rezultat U_POLIS edhe pse në një kontekst global dhe kombëtar të vështirë për shkak të krizës ekonomike, ka zbatuar me sukses një formulë tepër të avancuar që vjen nga përvojat e vendeve perëndimore, duke garantuar në përfundim një kampus universitar kompakt prej 1 hektar toke, me 2 objekte (1 prej të cilave rezervë dhe në dispozicion të nevojave të rritjes institucionit) si dhe me</p>

	<p>lehtësira të tjera si hapësira publike, terrene sportive, parkim, gjelbërim, etj.</p> <p>Universiteti është e lidhur mirë me qytetin me 4 linja transporti publik njëra prej të cilave ofrohet falas nga U_POLIS dhe tjetra nga QTU.</p>
--	---

**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10,000 titujsh në përputhje me programet që ofron.</p> <p>Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të U_POLIS.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm.</p> <p>Drejtuuesi i fakultetit por dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Buxhetit të Departamentit;</li> <li>✓ Donacioneve nga partnere të ndryshme;</li> <li>✓ Kontribute të projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj</li> <li>✓ Publikime/përkthime nga vete stafi i U_POLIS.</li> </ul> <p>Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, madje ofronte shërbim edhe ditëve të veçanta në fundjavë. Biblioteka ishte e pajisur me hapësirat e nevojshme për punë të pavarur.</p>
--	---

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>POLIS ka investuar dhe synon të vazhdojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukurore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundur mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.</p> <p>U_POLIS aktualisht ka 5 laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA</li> <li>2. Laboratori i MAC</li> <li>3. Laboratori i Eficences Energjetike</li> <li>4. Laboratori i Mjedisit</li> <li>5. Laboratori i Prototipizimit</li> </ol> <p>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për</p>
--	---



programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë" .

Një objektiv tjetër shumë i rëndësishëm i universitetit është ai i ndërtimit të laboratorit të testimit të materialeve dhe i provave gjeoteknike. Duke pas parasysh se krijimi i këtij të fundit kërkon një investim shumë të madh për tu ngritur brenda U\_POLIS. Aktualisht kërkesat e programit për realizimin e këtyre provave janë zgjidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit që universiteti ka me ALTE GeoStudio ku të gjitha orët laboratorike lidhur me testimet e materialeve kryhen pranë kësaj kompanie.

Mungesa e Laboratorit për shqyrtimin e materialeve dhe konstruksioneve pran Institucioni konsiderohet si çështje e pa zgjidhur e programit të studimit. Ndërsa, vlen të theksohet se një zhvillim kishte ndodhur pas dorëzimit të RVB, ku universiteti kishte nënshkruar një marrëveshje të re me kompaninë private PESPA GROUP, sipas së cilës do të mundësohej ngritja e laboratorit të testimit të materialeve dhe konstruksioneve - elementeve të konstruksioneve e që është shumë i rëndësishëm për këtë program studimi.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në institucion konfirmoi shume lehtë dhe qartë se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile "Strukturë" dhe "Gjeoteknikë", është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së. Duke i ofruar kështu studentëve një ambient komod dhe të përshtatshëm për ndjekjen e aktivitetit akademik por edhe atij social. Në dispozicion të studentëve ka auditorë, klasa, sallë konferencash, mjedise të përbashkëta ku studentët mund të punojnë por dhe ambiente sociale ku mund të kalojnë kohën e tyre. Këtu nuk mund të mos përmenden laboratorët dhe biblioteka.**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të katërt "Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit" janë plotësuar.**

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi stafin përkatës dhe u konsultua me dokumente të shkruara për të verifikuar burimet e financimit dhe menaxhimit të tyre nga U\_POLIS. Dhe në përfundim rezultoi se U\_POLIS është financuar nga një sërë të ardhurash si: tarifat e studimit, donacione; projekte të përbashkëta me partnere, fonde publike dhe të tjera.

Informacioni financiar i paraqitur më poshtë prezanton burimet e financimit ose të hyrat e universitetit sipas kategorisë: fonde publike, donacione dhe grande, tarifat e shkollimit, të ardhura të tjera projekte të përbashkëta etj në vlerë absolute dhe si % ndaj totalit të burimeve. Gjithashtu jep, përdorimin e burimeve financiare ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës sipas kategorisë, paga, shpenzime dhe investime duke treguar edhe burimin e financimit të tyre. Raporti financiar vazhdon me llogaritjen e kostos për student dhe me tej me ndarjen e përdorimeve sipas veprimtarive kryesore të institucioneve akademike që janë shpenzime për veprimtarinë akademike,

shpenzime për kërkim shkencor dhe shpenzime për veprimtarinë e administrimit. Ndarja sipas kategorive të veprimtarive është bërë bazuar në angazhimet reale të stafit dhe shpenzimeve në tërësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimin e MAS mbi veprimtaritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Burimet e financimit. Gjatë 2 viteve të fundit Universiteti POLIS është financuar nga disa burime si: tarifat e studimit, donacione dhe grande, projekte të përbashkëta dhe të ardhura të tjera.

**Në të ardhurat nga donacione** dhe grande janë pasqyruar pjesa vjetore që i takon periudhës e granteve në kuadër të projekteve Erasmus+ në të cilën Universiteti POLIS është partner, grande për realizimin e eventit Tirana Architecture Week 2016 etj.

**Në tarifat e shkollimit** përfshihen pagesat që bëjnë studentët gjatë vitit akademik përkatës për shërbimin arsimor.

**Në të ardhura nga projekte të përbashkëta** përfshihen përfitime direkte të Universitetit POLIS në kuadër të projekteve të përbashkëta me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto të ardhura nuk kanë hyrë në kontabilitetin dhe llogaritë e Universitetit dhe nuk janë administruar dhe taksuar në POLIS por nga partnerët me të cilët është zhvilluar projekti. Vetëm se në këtë rast përfitues i këtyre aktiviteteve ka qenë Universiteti POLIS. Vlera e këtij kontributi është një vlerësim duke marrë për bazë kostot e deklaruara të projektit. Këto fonde janë përfshirë në raport për të paraqitur një pamje të plotë të aktivitetit të Universitetit.

**Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhura** nga aktivitete dytësore si angazhime në hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit të territorit, konsulenca dhe ekspertiza profesionale, nenqera, zhvillim kurse dhe trajnime, zhvillim eventesh nga vetë institucioni dhe për të tretë etj.

Nga një analizë e burimeve të financimit shihet se përgjatë viteve është rritur pesha e burimeve të tjera të financimit duke realizuar synimin për diversifikimin e burimeve të financimit. Kështu sot të ardhurat nga këto burime janë kanë arritur në nivelin **23%** të totalit. Kjo është reflektim i strategjisë financiare të universitetit për diversifikimin e burimeve të financimit, uljen e ekspozimit ndaj risqeve të financimit afatshkurtër me synim qëndrueshmërinë financiare.

Rezulton se U\_POLIS përdor burime financiare të diversifikuara dhe mbështet më tepër në mjete të tjera financiare si grand për projekte të përbashkëta sesa në tarifat e studimit.

POLIS është ndër institucionet shqiptare që ka fituar rolin e partnerit lider në një program TEMPUS, duke mbajtur grandin prej 825,000 Euro, të siguruar nga Bashkimi Europian. Kjo tregon për besueshmërinë ndaj kapaciteteve të institucionit për menaxhimin e shumave të tilla. Ky projekt ka vijuar dhe me fitimin e shumë projekteve të tjera të Universitetit POLIS. Ku ka pas jo vetëm përfitime financiare por dhe shume mobilitete të stafit dhe studentëve.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të</p>	<p>Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhej rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve.</p> <p>Zyra e financës çdo vit hartonte bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani konsulencë financiare e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare si dhe nëpërmjet një eksperti kontabël të autorizuar kontrollonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave.</p>

<p>ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Në përfundim të këtij procesi hartojë një raport ku GVJ u vu në dijeni.</p>
<p><b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij.</p> <p>Këto raporte janë dhënë për të gjitha vitet akademike.</p> <p>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p><b>Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tillë që të shërbejë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.</b></p> <p><b>Diversifikimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet më rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të infrastrukturës lehtësuese siç mund të jenë laboratorët. Kjo, pavarësisht kostove të larta, institucioni ka treguar ndjeshmëri maksimale dhe është duke punuar për ngritjen e një laboratorit Testim Materialesh, gjë që do të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e studenteve.</b></p> <p><b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të katërt “Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare” janë plotësuar.</b></p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm grupi i vlerësimit shprehet:

*Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në “Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë” miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.*

NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS. Njësia përbëhet nga 8 anëtarë (Tabela 9, Aneks), një ndër të cilët është përfaqësues i Studentëve dhe një përfaqësues i Alumni. Është organ me karakter të përhershëm, këshillimor dhe vlerësues dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar NJBSC:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të universitetit;
2. Ngritja e një sistemi efikas për sigurimin dhe krijimin e kulturës të cilësisë në institucion;
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e POLIS, njësive, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.

Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësive. Kjo ndikonte drejtpërdrejt me kontrollimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Këtu mund të përmendim se një nga anëtarët ishte i angazhuar vetëm për menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, dikush tjetër monitorimin e procese administrative, kishte përfaqësues dhe përgjegjës për kontrollimin e procesit kërkimor shkencor etj. Të gjitha këto të krijojnë një tablo sa më të qartë dhe më konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Objektivat e NJBSC janë:

- ✓ monitorimi i vazhdueshëm i institucionit;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion; ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të U\_POLIS me institucione të tjera akademike, shkencore dhe jo akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ✓ dhe monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit.

Duhet theksuar se në fund të çdo viti akademik të dhënat e procesit të vlerësimit grumbullohen dhe hartohen në formë Raporti Vjetor<sup>1</sup> i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në dispozicion Senatit Akademik. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.

Dy vitet e fundit universiteti është duke u angazhuar në një projekt Erasmus+, Key Action 2, QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", për më shumë (<http://www.qainal.eu/page.aspx?id=1,2>).

Ky projekt ka për qëllim të krijojë dhe të mbështesë proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të mbështesë institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri për të arritur prioritetet e dy dokumenteve kryesore: "Rritja e ndikimit të Zhvillimit të BE-së: një Agjendën për Ndryshim" dhe "Arsimin e Lartë European në Botë". Projekti i drejtohet, prioritetit kombëtar për Projektin e Përbashkët, proceset e sigurimit të cilësisë dhe mekanizmave, nën kategorinë C - përmirësimin e menaxhimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjithashtu u konstatua se të gjitha programet e ofruar pranë POLIS janë të akredituara, dhe vete POLIS si institucion është akredituar dhe ri-akredituar dy here.

---

<sup>1</sup> Raportet Vjetore NJBSC, ndodhen të arkivuara në ambjentet e NJBSC.

Krahas këtyre vlerësimeve kombëtare POLIS, i është nënshkruar edhe procedurave të vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare si vijon:

1. Akreditim i përvitshëm nga autoritetet përgjegjëse Italiane në kuadër të programit të përbashkët doktoraturë midis Universitetit POLIS dhe Universitetit Ferrara, duke filluar që nga viti akademik 2013-2014 dhe në vazhdim.
2. Përmbushja e standardeve të cilësisë së Bashkimit Evropian dhe kërkesave të akreditimit në vendet e origjinës, IPAG Business School, Paris, Francë dhe IHS/ERASMUS University, Rotterdam, Netherlands në bashkëpunim më të cilat Universiteti POLIS ofron tre programe të studimi Master Profesional me nga tre profile secili.
3. Akreditim nga AESOP për programin e studimeve të integruara (5-vjeçare) Planifikim dhe Menaxhim Urban, data e lëshimit dhjetor 2015.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare /ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërimit - tezës;</li> </ol>	<p>POLIS ka pjesë strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdoruara nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj.</p> <p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJBSC, për secilin nga proceset akademike/administrative që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanëve të fakulteteve.</p> <p>Nga këto kontrole hartohen raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyrë për rregullsinë e procesit mësimor, si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, pjesëmarrja në mbrojtjen e tezave, ndjekja e ecurisë së studenteve, punësimi, opinionin i tyre, rezultatet e mara nga studimi i tregut etj.</p> <p>Rezultatet e përfituar nga pyetësorët i bëhen të ditur stafit, studenteve administratës dhe më gjerë.</p> <p>Te dhënat bëhen pjesë e Raportit Vjetor që institucion dërgon në MASR dhe ASCAL.</p> <p>Nga GVJ iu kërkua Sekretarisë Mësimore dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studenteve, metodat që përdoren për kontrollin e mësimnxënies.</p> <p>U njohëm me procesverbalet e studentëve, mënyrën e</p>



Etj.	<p>vlerësimin të pedagogëve për studentët, u konstatua se pjesëmarrja e studentëve ishte e detyrueshme.</p> <p>Me kënaqësi i konstatua se rezultatet e studentëve ishin të kënaqshme.</p>
<b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>U_POLIS, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Ky raport dërgohet në MAS dhe APAAL dhe janë lehtësisht të qasshme në bibliotekën e U_POLIS si nga studentët ashtu dhe stafi akademik.</p> <p>POLIS organizon pyetësor të brendshëm mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, dhe cilësinë e mësimdhënies dhe po planifikon ta publikojë në të dhënat kryesore në faqen e internetit të U_POLIS</p>
<b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programet Master i Shkencave vlerësohen pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJBSC në bashkëpunim me koordinatoren e procesit mësimor. Procesi vlerësimi deri më sot mbështetet në vlerësimin nga studentët, nga kolegët, nga eprorët dhe vetëvlerësimi. Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik me pjesëmarrje të lirë të stafit.</p> <p>Si përgjigje, <i>feedback</i> ndaj mangësive, problemeve apo sugjerimeve, drejtuesit kanë marrë masa konkrete që lidhen me procesin mësimor, strukturën didaktike apo cilësinë e korrektësinë e mësimdhënësve të veçantë.</p> <p>Këto rezultatet bëhen të njohura stafit dhe studentëve.</p>
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	<p>POLIS i është nënshtruar procesit të vlerësimin të jashtëm dhe ka fituar akreditimin periodik institucional për të tretën herë në vitin 2017 realizuar nga ASCAL dhe QAA.</p> <p>Ky proces është realizuar pavarësisht një akreditimi në fuqi atij të fituar përmes Urdhrit Nr. 267, datë 20.05.2016 “Për Akreditimin Institucional të Universitetit “POLIS””</p> <p>Kjo dëshmon qartë dëshirën e madhe të institucionit për përmirësimin e cilësisë së ofruar.</p> <p>Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si</p>

<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Senati Akademik, Rektorat etj.</p> <p>Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit.</p> <p>Ndërgjegjësimi i personelit të U_POLIS mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë. Ky proces starton me procedurat e punësimit të një anëtarit të ri në stafin akademik, njohjen e tij me vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit si dhe duke i kërkuar atij të bëhet pjesë e filozofisë së U_POLIS për të rritur cilësinë dhe për ta siguruar atë si vlerë sociale e kulturore.</p>
---	---

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

**Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar takimin me anëtarët e NJBSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:**

**NJBSC në POLIS ka një status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI, krijon një diversifikim dhe efikasitet në mënyrën se si operon në përmirësimin e cilësisë.**

**Kjo njësi ka një rregullore mbi të cilën bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e kontrollit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.**

**Ajo ka për detyrë kryesore të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.**

**Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.**

**Institucioni publikon rregullisht informacion te paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm. E gjithë veprimtaria e institucionit në lidhje me cilësinë përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të gjashtë “Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë” janë plotësuar.**

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

Misioni i përgjithshëm IAL është, siguri i “Njohurive, Teknologjisë dhe Liderit-it”, përmes kërkimit shkencor dhe të aplikuar, Institucioni zhvillon e promovon “ekselencën shkencore dhe inovacionin”, ku edukimi akademik përmirëson kompetencën kreative dhe gjithëpërfshirëse.



Universiteti POLIS si një platformë arsimore rajonale në territorin e Ballkanit Perëndimor dhe Mesdheun Lindor, synon krijimin e një gjenerate të re profesionistësh dhe shkencëtarësh me “përgjegjësi sociale”. IAL i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së studentëve në edukimin bazuar tek kërkimi shkencor, duke u angazhuar në projekte të komunitetit, shërbime konkrete për qeverisjen vendore, si dhe programe të kërkimit shkencor, zhvillimit dhe inovimit për shoqërinë civile, sipërmarrjen e autoritetet. Gjithashtu IAL ofron një “gamë të fokusuar studimesh” në Art-Dizajn, Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Planifikim Urban dhe Studime Mjedisore etj. Promovon “punën kërkimore” duke investuar në përfshirjen e “Kërkimit dhe Teknologjisë” në të gjitha programet e studimit, inkurajon bashkëveprimin ndërmjet fakulteteve dhe projekteve të përbashkëta me universitete të tjera ndërkombëtare, institute kërkimore dhe partnerë të tjerë nga fusha e biznesit<sup>2</sup>.

Misioni i programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi është që të përgatisë Studentët profesionalisht si Inxhinier Ndërtimi në profilet Gjeoteknikë dhe Strukturë me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik. Ky program studimi i ciklit të dytë konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë të programeve të cilët japin formime me bazë të gjerë në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit. Ndarja e studimeve në dy profilet përkatëse si Gjeoteknikë dhe Strukturë synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë<sup>3</sup>.

Programi i studimit për Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në profilet Gjeoteknikë dhe Strukturë ka 120 ECTS, zhvillohet në dy vite (2 x 60 ECTS) nga dy semestra (2 x 2 x 30). Përbajtja e programit përfshin grupacionet e lendeve-moduleve të kategorizuara në fusha disiplinore A - formim i përgjithshëm; B - karakterizuese; C - integruese; D - me përzgjedhje, E - formuese dhe F - teza e diplomës.

Lëndët sipas grupeve janë përbajtjesore secila për veten. Grupi i lëndëve B - karakterizuese, përbën grupin e lëndëve profesionale të cilat studentëve ju japin kompetenca në: Analizë dhe Llogari të Strukturave, Analiza të problemeve gjeoteknike, trajtimin e problemeve shkencore në fushën e inxhinierisë së Ndërtimit në nivelin shkencor, ndërsa grupacionet tjera të lëndëve përkatësisht programit plotësojnë tërësinë e kompetencave të përgjithshme të Studentit. Përbajtja e kredive sipas grupacioneve është e niveleve të Institucioneve relevante jashtë vendit duke theksuar se lëndët profesionale përbëjnë 40% të programit, ndërsa lëndët tjera janë me përqindje A-10%, C-13%, D-5%, E-8% dhe F -25%. Një gjykim i korrektësisë së programit është krahasimi i shkallës së përqindjes së lëndëve kur shohim se 1/4 (25%) e programit përbëhet nga Intershipi dhe Teza përkatësisht Projekt Diploma (semestri i II-të, i vitit të dytë).

Mësimet në semestër zgjasin 15 jave (semestri i parë fillon rreth 15 tetorit dhe përfundon në fund të janarit, ndërsa semestri i dytë fillon në mars dhe përfundon në mes të qershorit), ndërsa ka tre sezona provimi (janar-shkurt, qershor-korrik dhe shtator-tetor).

Plani mësimor është i shtrirë në katër semestra. Lëndët e përgjithshme Studentëve ju japin njohuri të përgjithshme për shkencat e Inxhinierisë, metodave kërkimore shkencore, gjuhë të huaj të cilat fillojnë në semestrin e parë. Grupi i lëndëve profesionale të ndara në pjesët e lëndëve të Teorisë së Strukturave dhe Gjeomekanikës me lëndët për llogarinë e strukturave (Konstruksionet Beton Arme, Konstruksionet Metalike) dhe gjeoteknikës (Objektet Hidroteknike, Qëndrueshmëri pjerrësish) janë lëndë/module që i takojnë semestrin të dytë dhe të tretë. Gjithashtu grupet e lëndëve zgjedhore dhe plotësuese (Projektim Arkitektonik, Gjeoteknikë Eksperimentale, Vepra Mbrojtëse, Konstruksione Druri, Konstruksione Muraturë etj) janë lëndë të fushave të ngushta profesionale të cilat mbushin Studentin me kompetenca të shtuara në Inxhinieri Ndërtimi.

Literatura e që përdoret nga Mësimdhënësit dhe ju përcillet Studentëve është Literaturë e re dhe bashkëkohore. Studentët kanë mundësi të qasjes në Bibliotekën e Fakultetit ku janë të siguruar

---

<sup>2</sup> Marrë nga RVB dhe faqja në internet [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

<sup>3</sup> Marrë nga RVB dhe faqja në internet [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

shumë tituj - libra profesionale në gjuhën shqipe dhe të huaj (kryesisht Anglisht), dispenca nga leksionet e mësimdhënësve, si dhe mundësi të qasjes në e-library të Evropës.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit:**

Gjenerata e parë ka filluar në vitin shkollor 2016/2017, gjenerata e dytë në vitin 2017/2018.

Në vija të përgjithshme disa nga objektivat mund të shprehen si më poshtë:

- ✓ Të aftësojë studentët në njohjen e historisë, koncepteve, dijeve dhe praktikave shkencore inxhinierike dhe të zhvillojnë një aftësi për të vlerësuar dhe për të interpretuar problemet inxhinierike.
- ✓ T'u sigurojë studentëve njohurive themelore dhe të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve inxhinierike në lidhje me profilet e Gjeoteknikës dhe Strukturës.
- ✓ Të përgatisë studentët me aspektet teorike jo vetëm në fushën teknike por dhe në ato të menaxhimit dhe të qëndrueshmërisë.
- ✓ Të përgatisë studentët me një qasje efektive në një mjedis shumë disiplinor dhe praktik të fushës së ndërtimit.
- ✓ Të fitojnë njohuritë dhe aftësitë për punësim në sektorin publik dhe privat të lidhur me fushën e ndërtimit.
- ✓ Të sigurojë një sfond shkencor për studime ose kërkime të mëtejshme.
- ✓ Të aftësojë studentët me njohuritë bazë të komunikimit me shkrim dhe verbal, të nevojshme për një karrierë të suksesshme profesionale. Të njohë studentët me çështje e etikës profesionale, sigurisë si dhe impaktin shoqëror të kësaj disipline.
- ✓ Të hapë horizonte të reja për këtë profesion në Shqipëri si restaurimi i trashëgimisë kulturore, projektimi i qëndrueshëm, dizajni parametrik, dizajni estetik strukturor, etj.

#### **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

Program i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi - Strukturë dhe Gjeoteknikë me kohëzgjatje 2 vjeçare përmban 14 lëndë të organizuara në 20 module, te cilat përfshijnë internshipin profesional si edhe temën dhe projekt diplomën. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Diplomë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në se plotësojnë 120 kreditë sipas sistemit ECTS. Kreditë janë të llogaritura sipas sistemit ECTS.

➤ 1 vit akademik ka	30 javë mësimore në auditor
➤ 1 Semestër ka	15 javë mësimore në auditor
➤ 1 ECTS	25 ore mësimore
➤ 1 ore mësimi	60' (minuta)


#### **Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Grupi A i lëndëve për formim të përgjithshëm ka 12 ECTS, Grupi B i lëndëve profesionale - karakterizuese përmban 48 ECTS, Grupi C i lëndëve integruese përbën 15 ECTS, Grupi D i lëndëve zgjedhore përbën 6 ECTS, Grupi i lëndëve plotësuese E ka 9 ECTS ndërsa Internshipi 6 ECTS dhe Diploma 24 ECTS. Për secilën lëndë është llogaritur pesha që Studenti ka për të bërë punë - leksione, ushtrime, seminare, laboratorë dhe orë mësimi dhe shuma e orëve është ndarë në 25. Secila lëndë ka numër të kredive të plotëpjestueshëm me 3 duke fituar mundësi të ndërhyrjes eventuale të lëndëve/moduleve tjera eventuale të arritura nga mobilitetet e Studentëve.

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

- Për leksionet            12-13 orë në auditor dhe            12-13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret            8-12 orë në auditor dhe            13-17 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratorët        16 orë në auditor dhe            9 orë punë e pavarur e studentit
- Për Prakt. lëndore    10-12 orë në auditor dhe            13-15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale: 20 orë në auditor dhe            5 orë punë e pavarur e studentit

**Plani mësimor MSc Inxhinieri Ndertimi - Profili Gjeoteknikë & Strukturë 2017-2018, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. (Tabela 10)**



**PLANI MESIMOR MSc Inxhinieri Ndertimi - Profili Gjeoteknikë & Strukturë 2017-2018**

KODI I LENDES			KREDITET TOTAL	TOT. ORE MESIMORE NE AUDITOR	LEKSIONE	KREDITE L	SEMINARE	KREDITE S	STUDIO / ushtrime / workshop	KREDITE studio / ushtrime / workshop	projekt kursi / detyra	KREDITE projekt kursi / det	PRAKTIKE	KREDITE P	ore javore LEKSIONE	Ore javore seminare dhe / ose aktivite te tjera	ORE JAVORE TOTAL
<b>VITI I semestri I</b>																	
DSI	Dinamika e Strukturave dhe Inxhineria Sizmike	Dr. E. Luca	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
KBA2	Konstruksione Beton Arme 2	Dr. E. Luca	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
TAS1	Teori e Avancuar e Strukturave 1 (Metoda Energjitike)	Prof. Dr. Gj. Ikonomi, I. Rusi	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
MPP	Metoda Probabilitare ne Projektim	Dr. S. Sukaj	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
KHI	Konstruksione Hidroteknike	Prof. Dr. Gj. Ikonomi	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
PAR	Projektim Arkitektonik	Dr. Loris Rossi	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	<b>Ore ne audiitor</b>			<b>180.0</b>													
	<b>Ore mesatare javore</b>		<b>33</b>	<b>12.0</b>													
<b>VITI I semestri II</b>																	
TIQ	Teknologji dhe Infrastruktura Qyteti (Rruge, Ura, Tunele)	Prof. Dr. Gj. Ikonomi, MSc Xh. Ngjeqari / MSc G. Delli	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
LMP1	Lende me Perzgjedhje 1		3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
PST	Probabilitet dhe Statistike	Dr. G. Rembeci	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
TAS2	Teori e Avancuar e Strukturave 2 (Qendrueshmeri)	Prof. Dr. Gj. Ikonomi, I. Rusi	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
MSH	Mekanike Shkembi	Prof. Dr. L. Bozo / I. Rusi	6	72	36	3	36	3							2.4	2.4	4.8
MNR	Metoda Numerike	Prof. Dr. M. Kolaneci, I. Rusi	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	<b>Ore ne audiitor</b>		<b>27</b>	<b>276.0</b>													
	<b>Ore mesatare javore</b>			<b>18.4</b>													
	<b>Ore Total ne auditor</b>			<b>456.0</b>													
	<b>Ore mesatare javore</b>			<b>15.2</b>													

**PLANI MESIMOR MSc Inxhinieri Ndertimi - Profili Gjeoteknikë & Strukturë 2017-2018**

VITI II semestri I																		
Gjeoteknikë	KGJ	Kode ne Gjeoteknike	Prof. Dr. L. Bozo	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Strukturë	RPS	Restaurim dhe Perforcim i Strukturave	Doc. Dr. M. Guri / A. Marku	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Gjeoteknikë	DGZ	Dinamike Dherash dhe Gjeoteknike Sizmike	Prof. Dr. L. Bozo / I. Rusi	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Gjeoteknikë	GJE	Gjeoteknike Eksperimentale dhe Rrugore	Prof. Dr. L. Bozo / I. Rusi	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Strukturë	KBA3	Konstruksione Beton Arme 3 (Special)	Dr. E. Luca	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Strukturë	KME	Konstruksione Metalike 2	Doc. Dr. M. Guri / A. Marku	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
	TPZ	Teza dhe Projekt Diploma	Prof. Dr. L. Bozo, Prof. Dr. Gj. Konomi, Doc. Dr. A. Shtylla, Doc. Dr. M. Guri, Dr. E. Luca, Dr. E. Dobjani, Dr. S. Sukaj	9	88	8	1			80	8					0.5333	5.3333	5.8667
	LMP2	Lende me Perzgjedhje 2		3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
		WSHP TDW Learnscapes 25 - 30 Shtator																
		Ore ne audiitor		30	484.0													
		Ore mesatare javore			32.3													
VITI II semestri II																		
Gjeoteknikë	QPJ	Qëndrueshmëri Pjerrësish	Prof. Dr. L. Bozo	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
Strukturë	ASA	Analize dhe Projektim Strukturor Kompjuterik i Avancuar	Dr. E. Luca	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
	AMK	Metoda Kerkimore te Avancuara	M. Hoxha	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	TPZ	Teza dhe Projekt Diploma	Prof. Dr. L. Bozo, Prof. Dr. Gj. Konomi, Doc. Dr. A. Shtylla, Doc. Dr. M. Guri, Dr. E. Luca, Dr. E. Dobjani, Dr. S. Sukaj	15	74	16	2			50	5	8	8			1.0667	3.8667	4.9333
	INP	Internship Profesional		6	120								120	6	0	8	8	
		Ore ne audiitor			194.0													
		Ore mesatare javore		30	12.9													
		Ore Total ne auditor			678.0													
		Ore mesatare javore			22.6													

	LMP2	Lende me perzgjedhje 2																
	LSC	WSHP Learnscapes	<b>M. Cebuj, G. Papa</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	GJR	<i>Gjeoteknike Rrugore [Probleme të projektimit dhe të sigurisë rrugore]</i>	<b>Xh. Ngjeqari</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	VMB	<i>Vepra Mbrojtëse</i>	<b>Prof. Dr. Gj. Ikonimi</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4

	LMP1	Lende me perzgjedhje 1																
	URT	<i>Urbanistike Teknike</i>	<b>Z. Barjami</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
Gjeoteknikë	TTH	Themelet e Thella	<b>Prof. Dr. L. Bozo / I. Rusi</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
Strukturë	MAN	Materiale te Avancuara Ndërtimi	<b>Dr. Loris Rossi / Dr. E. Dobjani</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	EKO	<i>Eurokode</i>	<b>Doc Dr. A. Shtylla</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4

	LMP2	Lende me perzgjedhje 2																
	LSC	WSHP Learnscapes	<b>Dr. E. Luca, M. Cebuj, G. Papa</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	KDR	<i>Konstruksione Druri</i>	<b>Dr. E. Luca</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4
	KMU	<i>Konstruksione Murature</i>	<b>Doc. Dr M. Guri</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 10/1):**

Ky program Akreditohet për herën e parë. Ndërsa ndryshimet e bëra të lëndëve nga viti 2016/2017 në vitin 2017/2018 janë më pak se 20% dhe vlerësojmë se janë brenda kufijve të lejuar.

**Ndryshimet ne PLANIN MESIMOR MSc Inxhinieri Ndertimi - Profili Gjeoteknikë & Strukturë, krahasuar me planin e licencimit**

	KODI I LENDES			KREDITET TOTAL	TOT. ORE MESIMORE NE AUDITOR	LEKSIONE	KREDITE L	SEMINARE	KREDITE S	STUDIO / ushtrime / workshop	KREDITE studio / ushtrime / workshop	projekt kursi / detyra	KREDITE projekt kursi / det	PRAKTIKE	KREDITE P	ore javore LEKSIONE	Ore javore seminare dhe / ose aktivite te tjera	ORE JAVORE TOTAL
		<b>VITI I semestri I</b>																
	DSI	Dinamika e Strukturave dhe Inxhinieria Sizmike	<b>Ndryshim semestri nga II ne sim e Pare</b>	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4
	TIQ	Teknologji dhe Infrastruktura Qyteti (Rruge,Ura,Tunele)	<b>Ndryshim nga semestri II viti II ne sim e Dyte te vitit te pare</b>	6	60	36	3	24	3							2.4	1.6	4

	LMP1	Lende me përzgjedhje 1																
Gjeoteknikë	TTH	Themelet e Thella	<b>Futur lende e re ne liste</b>	3	36	12	1	12	1	12	1					0.8	1.6	2.4



**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 10)**

Personeli Akademik ka një profilizim sipas disiplinave dhe se për dhënien e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, studiove janë pedagog me formim profesional dhe shkencor mjaft të mirë me grada Doktor deri te Profesor Doktor, ose edhe disa prej tyre në vazhdim e sipër për marrjen e gradës Doktor. (Shih Tabelën më sipër)

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

Syllabuset e çdo lënde janë përmbajtjesore dhe pasqyrojnë pothuajse të gjitha elementet e nevojshme, duke filluar nga bartësi i lëndës, përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, Objektivat e lëndës të cilat të detajuara për secilën lëndë janë nën ombrellën e objektivave të përgjithshme të profilit. Objektivat përmbajnë brenda vetes edhe rezultatet e nxënies ose kompetencave për Studentin.

Secili nga syllabuset e lëndëve ka përmbajtjen e shtrirë në semestër në 14 - 15 javët sa zgjat semestri, mjetet didaktike si dhe Literaturën e detyruar dhe rekomanduar.

**Vlerësim për cilësinë e syllabuseve**

Nga analiza e cilësisë së syllabuseve rezulton se ato janë në pajtim me kërkesat e programit të studimit, gjykuar nga përmbajta e tyre përkatësisht nga specifikat e veçanta (peshat e tyre, orët, kreditë ECTS, kërkesat për studentin), njohurit e nevojshme e të domosdoshme që e përgatisin Studentin.

Për të ardhmen rekomandohet që të veçohen Rezultatet e Nxënies (Learning Outcomes) nga Objektivat për secilën lëndë mësimore nga të cilat do të identifikoheshin kompetencat e profesionit.

Pas përfundimit të praktikës, Studenti fiton 6 ECTS dhe nuk vlerësohet me notë (6 ECTS nuk hynë në notën përfundimtare të studimeve). Totali i orëve të punës në praktikë duhet të përmbajë 120 orë. Sipas Bolonjës të gjitha lëndët/modulet (kreditë e fituara) duhet të jetë të vlerësuara me notë, prandaj Institucioni rekomandohet që praktikën profesionale të e vlerësoj me notë.

**Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion**

Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit ekzistojnë syllabuset të cilat në fillim të semestrave përkatëse ju prezantohen Studentëve dhe duke u bërë publike. Nga vizita në Institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatojmë se janë në përputhje me standardet.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kreditë, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); <b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredi;	Ky program studimi i ciklit të dytë konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i cili jep formim më të gjerë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Ndarja e studimeve në dy profilet përkatëse Gjeoteknikë dhe Strukturë synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë.

	<p>Programi i studimit për MSc Inxhinieri Ndërtimi, profile Strukturë dhe Gjeoteknikë me 120 ECTS, me nga 30 ECTS për çdo semestër plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të kredive prej 60 ECTS në vit.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit MSc arrin që nëpërmjet lëndëve të përgjithshme, profesionale, zgjedhore dhe formuese, gjithnjë duke pas parasysh praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës të krijoj kuadër profesional me Kompetenca më të thelluara në fushën e Inxhinierisë së ndërtimeve. Kompetencat e Studentit janë të thelluar në aspektin teorik shkencor, profesional si dhe praktik. Me kompetencat e fituara pas diplomimit Studenti ka mund të vazhdoj në tregun e punës ose edhe në studimet e mëtejme më të thelluara sikur janë studimet e doktoratës si cikël i tretë.</p> <p>Duke qenë shumë të qarta objektivat e përgjithshme të programit si dhe objektivat më të detajuara të lëndëve të programit të cilat kanë target tregun e punës me një gamë më të gjerë në fushën e Strukturave dhe të projekteve ose problemeve Gjeoteknikë në nivelin lokal dhe ndërkombëtar, ato sigurojnë edhe mundësin e studimeve dhe njohurive tjera shtesë.</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e studimeve, programi i studimit, lëndët me syllabuset e tyre synojnë arritjen e qëllimeve të përgjithshme në rritjen e dijeve shkencore teorike të Inxhinierisë së Ndërtimeve si dhe anës praktike profesionale të tyre. Prandaj programi i studimeve parashikon aktivitete kërkimore koherente me projekte të veçanta përmes praktikës profesionale.</p> <p>Shumë qartë vërehen objektivat e përgjithshme të cilat arrihen përmes organizimit të mësimin përmes mësimin, ushtrimeve, laboratorëve, intershipit.</p>

	<p>Metodat e vlerësimit të identifikuara gjatë vizitës në Institucion vlerësohen si shumë bashkëkohore, sistematike, uniforme pa ngarkesa të koncentruara për Studentin.</p> <p>Të gjitha metodat e vlerësimit janë të precizuara në syllabuset e lëndëve dhe të cilat respektohen. Ato janë sistematike dhe progresive.</p> <p>Gjatë vizitës janë verifikuar edhe arritjet e studentëve në vitet dhe lëndët paraprahe të cilat janë në nivel të kënaqshëm.</p>
--	---

**Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve Europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Bashkëpunimi i Institucionit me Vendet ndërkombëtare është njëra nga objektivat e përgjithshme të Institucionit duke provuar që produkti i nxjerrur të jetë i plotësuar me njëri nga objektivat që pas përfundimit të studimeve Studenti të jetë i gatshëm për tregun e punës në vend dhe jashtë tij në Europë.</p> <p>Ky Program Studimi zhvillohet sipas sistemit të Bolonjës, kurikula e tyre është lehtë e përputhshme me programet e studimeve Europiane, mobiliteti i studentëve, transferimi i studimeve mund të realizohet me lehtësi duke marr parasysh lëndët, përmbajtjet e tyre, kreditë e tyre, metodat e vlerësimit.</p> <p>Objektivat e përgjithshme përkojnë me objektivat e përcaktuara me ligjet vendore si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. Një element shume përmbajtjesor të cilësisë së përgatitjes së studentëve për tregun European është se standardet e trajtimit të strukturave nuk janë vetëm ato Shqiptare mirëpo janë edhe Eurokodet.</p>
---	---

**Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Praktika Profesionale, vizitat nëpër kantiere të ndryshme ndërtimi gjatë kohës së studimit ishin tregues i arritjes së njohurive direkt me strukturat dhe faktorët e ndikimit të përgjithshëm të sjelljes, ndërtimit, efikasitet, ruajtjes së Energjisë së tyre.</p> <p>Universiteti POLIS është Institut privat i Arsimit të Lartë i cili është i njohur për përcaktimin e fushave të studimeve të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës. Prandaj edhe Objektivat e përgjithshme të Institutit dalin shumë të qarta.</p> <p>Personeli Akademik i punësuar në Institucion është i motivuar për bashkëpunim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti është kreativ dhe pjesëmarrës në shumë konferenca dhe projekte ndërkombëtare në të cilat personeli Akademik ka mundësi reale për pjesëmarrje, prezantim të punimeve shkencore, shkëmbim përvojash akademike, etj.</p> <p>Edhe shumë prurje të personelit Akademik nga jashtë në Institucion janë tregues i synimit të realizimit të objektivave të programit.</p>
---	---

<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Vlerësoar nga përmbajtja e programit të studimit për nivelin Master i Shkencave, përmbajtjes së lëndëve, aktiviteteve mësimore, cilësive përkatësisht objektivave të arritura me rastin e diplomimit të studentit themi se ky produkt mund të i ofrohet tregut vendor si dhe rajonal dhe Europian.</p> <p>Disa nga kompetencat pas përfundimit të studimeve; projektimi i veprave publike si stacione e terminale, qendra kulturore e tregtare, stadione e pallate sporti, muze e qendra kulturore, autostrada e ura apo tunele, ku veç cilësive të mira strukturore ka nevojë edhe për ndjeshmëri të lartë për estetikë vizuale publike.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> </ul> <p>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi jep mundësinë për të hyrë në tregun e punës dhe në shërbimin civil.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve në këtë nivel të MSc Inxhinieri Ndërtimi Studenti mund të punësohet në,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ sektorin privat të studiove të projektimit inxhinierik dhe arkitektonik;</li> <li>✓ sektori i shërbimeve dhe prodhimit industrial në fushën e ndërtimit ( materialet, pajisje, etj.);</li> <li>✓ sektori i qeverisjes vendore, duke filluar që nga bashkitë e komunat e deri tek qarku apo rajonet;</li> <li>✓ sektorët kryesore që influencojnë zhvillimin në nivel qendror; Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus kryesor fushën e ndërtimeve siç mund të jenë psh. teknologjia e ndërtimit dhe e materialeve të ndërtimit, standardet e projektimit të objekteve të ndryshme lidhur me funksionin për të cilat</li> </ul> <p>IAL i ofron tregut të punës një spektër të gjerë të fushave përkatësisht disiplinave nga Arkitektura dhe Inxhinieria e Ndërtimit. Duke ndërlidhur këto disiplina edhe gjatë kohës së studimeve, Studenti pas diplomimit merr kompetencë edhe me punë në grupe të fushave lidhëse sikur janë Arkitektura, Gjeoteknike, Planifikimi etj. dhe këto cilësi konsiderohen si shumë aktuale në nivele ndërkombëtare dhe profile të cilat i dëshiron tregu i punës.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program Studimi për Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Në masën e njerzimit - popullatës nivelet e edukimeve shkencore rrisin interesin kombëtar duke i shërbyer popullit në ngritjen e cilësisë së banimit, Eficiencës së Energjisë, si dhe</p>

	zvogëlojnë në masë të madhe Hazardet e mundshme të vendit.
<b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite Europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite Europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Program i Studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi zgjatë 2-vite akademike, në katër semestra, me kohë të plotë. Ky program studimi përmban 14 lëndë të organizuara në 20 module, duke përfshirë praktikën profesionale si edhe temën dhe projekt diplomën duke siguruar në tërësi 120 ECTS. Për secilin semestër janë të shpërndara nga 30 ECTS në mënyrë konstante. Në vitin e dytë, semestri i dytë përmban praktikën profesionale, me tezat dhe punimin e diplomës që i sigurojnë studentit 30ECTS.
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; <b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Secili student i regjistruar në Universitetin POLIS, ka informacionet paraprake për përmbajtjen e programit të studimit, klasifikimin e lëndëve, syllabuset e tyre përmes formave elektronike ne web faqen e universitetit si dhe takimet direkte me studentet.  Syllabuset e lëndëve ekzistojnë në formë elektronike si dhe në formë të shkruar në arkivin e shkollës. Secili syllabus përmban informatat e përgjithshme dhe të veçanta për secilën lëndë.
<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; <b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Programi i diplomimit në IAL është me një program të qartë të shkruar në rregulloren e studimeve. Pas përfundimit të lëndëve mësimore në tre semestra, në semestrin e katërt të studimeve punohen tezat e kërkimit shkencorë së bashku me praktikën profesionale të cilat përmbajnë 30 ECTS.  Institucioni ka të përgatitur formën teknike të diplomës si dhe suplementin e diplomës për secilin student i cili diplomon në Master të Shkencave të Inxhinierisë në profilet Strukturë përkatësisht Gjeoteknikë.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p><b>GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në profilet Gjeoteknikë dhe Strukturë është përmbajtjesor, me një organizim shumë të mirë të Personelit të angazhuar në Institucion. Ky program studimi është i studiuar dhe i projektuar në atë mënyrë që të siguroj një produkt të mirë të përgatitur në aspektin teorik shkencor dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë.</b></p> <p><b>Përmbajtja e programit të studimit konsiston me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe si rezultat klasifikimi i lëndëve, përmbajtja e tyre, puna kërkimore dhe mësimore që zhvillohet për të përmbush objektivat e programit sigurojnë se ky produkt do të ketë plasman të mirë.</b></p> <p><b>Program i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi - Strukturë dhe Gjeoteknikë me kohëzgjatje 2 vjeçare përmban 14 lëndë të organizuara në 20 module, te cilat përfshijnë</b></p>	



**internship-in profesional si edhe temën dhe projekt diplomën.**

**Studentët përmbushin kërkesat për titullin Diplomë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në se plotësojnë 120 kreditë sipas sistemit ECTS.**

**Shtrirja e Programit në katër semestra ka kuptim duke vlerësuar planin mësimor si dhe radhitjen e lëndëve nga semestri në semestër (duke fituar për çdo semestër nga 30 ECTS) dhe gjatë rrugëtimit të studimeve Studenti mbush kompetencat (rezultatet e nxënies) në mënyrë graduale dhe pa qenë shumë i ngarkuar që do të thotë se studimi është gradual deri në finalizim me punimin e tezave kërkimore dhe Diplomën kur studentit fiton 120 ECTS dhe mund të i ushtrojë kompetencat e fituara në tregun e punës.**

## **8. Mësimdhënia**

### **Pjesa përshkimore**

Universiteti vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe provimeve të programit të ciklit të dytë për Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi. Të gjitha rregulloret janë të publikuara dhe i komunikohen gjithë stafit përmes formave zyrtare.

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Instrumentet e mësimdhënies të cilat zbatohen në Institucion janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë ligjërimeve, përvojë të madhe profesionale të stafit të Pedagogëve të Angazhuar si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbërthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënia një njëdrejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin jo vetëm të lektorit mirëpo edhe të moderatorit.

Stafi i Pedagogëve përgatitet gjithmonë me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies duke ju ofruar mundësi e pjesëmarrjes edhe nëpër projekte të ndryshme sikur projekti ConSus: 543742-TEMPUS-1-AT-TEMPUS-JPHES. Koordinatorja e programit të Studimit e cila ishte trajnuar për metodat inovative të mësimdhënies te projekti që Institucioni ishte pjesë e tij, ajo shpërndau eksperiencën e fituar te pjesa tjetër e Pedagogëve. Konkretisht një pjesë e metodave të mësimdhënies të zbatuara jo vetëm në këtë program studimi por në të gjithë universitetin janë: të mësuarit e bazuar tek problemi (PBL), World Café, Modeli Canvas – strukturimi i ideve të qëndrueshme të biznesit, Lojrat edukative, etj.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë brenda në auditor apo në terren, nëse do të jetë i zhvilluar në trajtë monologu nga ana e lektorit apo në trajtë dialogu. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën përkatëse. Por në programin e studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi", duke qenë një degë mjaft aplikative, rekomandohet dhe këshillohet të përdoren metoda dhe forma mësimdhënie që përfshijnë praktika konkrete në terren, laboratorë, vizita, sondazhe, vëzhgime, etj.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies në Institucion.



Secila lëndë mësimore ka dispensën e sajë dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë në bibliotekën e Universitetit e cila ka një fond të mirë të librave profesionale në gjuhë shqipe dhe të huaj - kryesisht Angleze.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Ngarkesa e realizimit të programit studimor në auditor e prezantuar nga Institucioni: Leksione 684 orë, Seminare/Laboratorë 480 orë, Ushtrime 214 orë, Praktikë profesionale 120 orë, kurse-detyra 8 orë. Në total 1506 orë, që i bie mesatarisht 5.02 orë pune në ditë gjatë kohës së studimeve (katër semestra, për çdo semestër 15 javë mësimi).

Leksionet zhvillohen në ambientet e Fakultetit përmes projektorëve, tabelave, kompjuterëve. Seminaret dhe ushtrimet zhvillohen në klasë dhe jashtë saj me punë të pavarur të Studentëve. Laboratorët zhvillohen në grupe të vogla me studentë, Praktika profesionale zhvillohet në kantiere ku Institucioni ju jep preferencat.

### **Format e kontrollit të njohurive**

Vlerësimi i njohurive të arritura të studentit bëhet sipas sistemeve bashkëkohore Europiane. Secili pedagog brenda lëndës së vet vlerësimin e shpërndanë lirisht (sipas peshës së lëndës, ushtrimeve, Laboratorëve etj) gjithmonë duke u bazuar në syllabusin e lëndës së veçantë të programit. Vlerësimi i studentëve bëhet kryesisht nga këto parime; pjesëmarrja aktive në leksione 10%, Plotësimi i detyrimeve nga laboratorët ose detyrave të kursit 30% deri 60%, testimet gjatë vitit 5% deri 20%, provimi përfundimtarë 20% deri 60%, veprime tjera deri 10% duke mbush totalin e vlerësimit në shkallën 100%. Përqindjet përfundimtare nga arritjet ndahen në segmente për vlerësim me notë. Notat janë nga 4 deri 10. Nota 4 është not jo kaluese, ndërsa notat nga 5 deri në 10 janë kaluese.

Pas vlerësimit dhe shpalljes së notës, nëse studentin nuk është i kënaqur mund të paraqes ankesë brenda tre ditëve. Studenti mund të kërkoj edhe konsultime me mësimdhënësin lidhur me provimin. Notimi i studentëve është sistem i kontrolluar i sigurisë. Ato ruhen nga Administrata me shumë kujdes, korrektësi dhe saktësi.

### **Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Studentët janë të angazhuar në projekte të ndryshme të cilët bashkëpunojnë me profilet tjera të fakultetit për t'i realizuar. Gjithashtu Institucioni organizon shumë vizita nëpër kantiere në vend si dhe planifikon të organizoj një udhëtim nëpër Europë me qëllim të informimit të Studentëve me ndërtimet dhe veprat më prestigjioze në Evropë.

Studentëve ju mundësua pjesëmarrja nëpër aktivitetet Akademike, kërkimore dhe shkencore të organizuara nga Institucioni. Ndër aktivitetet e radhitura të kësaj fushe mund të gjenden emrat e disa studentëve të cilët kishin marrë pjesë në konferenca sikur: Konferenca e 66-të e Gjeomekanikës e zhvilluar në Salzburg, pjesëmarrja në projekte të MetroPOLIS. etj. Vlen të përmendet gjithsesi mobiliteti i Studentëve të profilet Gjeoteknikë në Universitetin Minho të Portugalisë.

Nga vizita e bërë në Institucion dhe Raporti i vlerësimit të brendshëm nuk janë vërejtur ndryshime sa i përket treguesve të sipërm të përshkruar.

Universiteti ka të organizuar mjaft mirë jetën në kampus. Brenda sajë ka Senatit Studentor që është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike por dhe me ato jashtë akademike që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve. ZMSKK është Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) dhe është një njësi e cila asiston dhe ndjek studentet, si gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në

treg, arritjet e tyre, lobimin për mbrojtjen e te drejtave të profesionit. Përgatitja për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme. etj.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkimore

Qasja e parë e një kandidati për të aplikuar në studime në Universitetin POLIS është faqja e internetit dhe forma e formularit e cila plotësohet nga kandidati me shënime personale biografike. Me pas është lista e dokumentacionit të regjistrimit e cila përmban radhitjen e kërkesave të: diplomës Universitare BsC, transkripti i notave Bsc, diploma e shkollës së mesme dhe rezultati i maturës, Vetëdeklarata noteriale (mbi regjistrimin), CV-ja personale, Letër motivimi etj.. si dhe udhëzimet tjera për veprim të regjistrimit.

Institucioni ka filluar me gjeneratën e parë në këtë program të studimeve në vitin 2016/2017, gjenerata e dytë e regjistruar është në vitin 2017/2018. Duke qenë program i studimit në dy vite ende nuk kanë kandidat të diplomuar. Ne korrik te vitit 2018 pritet që të dalin diplomantët e parë. Duke pas parasysh këtë fakt nuk ka tregues të matshëm për të diplomuarit. Numri i të regjistruarve në këtë profil është:

- Viti akademik 2016-2017 gjithsej 17 studentë,
  - Viti akademik 2016-2017 gjithsej 39 studentë
- Gjithsej 56 studentë.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

#### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Në këtë program studimi mund të regjistrohen ata kandidat që kanë fituar diplomë të nivelit të studimit bachelor (180 ECTS) e cila pikë është e përshkruar në rregulloren e programit të studimit, sipas akteve në fuqi dhe kanë notën mesatare të ponderuar të notave të studimit (nota mesatare e ponderuar nënkupton mesatarja sipas peshës së lëndës dhe suksesit) sipas kriterëve të përcaktuara nga Institucioni.

#### **Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Institucioni ka rregulloren për regjistrim të studentëve. Ka një mori kërkesash të dokumentacionit dhe kushteve për regjistrim të këtij profili. Ky program studimi konsiderohet si vazhdim i studimeve të nivelit bachelor Inxhinieri Ndërtimi që institucioni ka brenda vetes. Ndërsa për pranim të studentëve të profileve tjera të fushës së inxhinierisë teknike (p.sh mekanika) duhet të kalohen lëndët diferenciale të cilat janë të caktuara me rregullore. Këto lëndë nuk futen në mesataren e studimeve.

#### **Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Kalueshmëria e gjeneratës është 58%.

#### **Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Ende nuk ka ardhur brezi i pare i të diplomuarve.

#### **Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Ka disa studentë të cilët kanë fituar mobilitet në Universitetin Minho të Portugalisë. Ka edhe disa raste kur studentët kanë mobilitetet nga Institucionet tjera në vend.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Ka disa studentë të cilët kanë fituar punë në rastet kur ata kanë realizuar praktikën profesionale, në studio projektimi ose edhe ndërmarrje ndërtimi.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje/jo në përputhje me diplomën)**

N/A

Gjatë vizitës së Institucionit GVJ ka verifikuar procesin administrimit të notave nga mësimdhënësit deri te administrata, procesi i parashtrimit të ankesës së studentit për provim dhe zgjidhja e sajë, bartja e shënimeve në librat e evidencës të realizuar nga administrata.

I gjithë procesi është transparent ndërsa siguria e informacioneve është shumë e madhe. Nuk është vërejtur ndonjë ndryshim nga RVB dhe gjetjeve nga vizita e bërë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimin të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimin dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimin.</p>	<p>Në këtë program studimi janë regjistruar studentë të cilët kanë plotësuar kriteret që përcakton legjislatura e vendit për studimet e nivelit Master i Shkencave si dhe rregullorja e studimit të Institucionit. Të gjithë studentë që janë të pranuar në studime në këtë program zotërojnë diplomën Bachelor me 180ECTS.</p> <p>Studentët e pranuar kanë plotësuar kriteret e përcaktuara nga rregullorja e programit të Institucionit.</p> <p>Për studentët e pranuar në studime ishte kusht që përpara regjistrimit në këtë program duhet të dëshmojnë certifikatën e testit të gjuhës Angleze sipas udhëzimit të përcaktuar nga Institucionet e MASR-it.</p> <p>Institucioni dëshmon se teston vlerësimin herë pas here të politikave të pranimin të studentëve në programe studimi si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin eventual të kriterëve të pranimin.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Të gjitha informacionet lidhur me studentët, sukseset e tyre, punësimet e tyre në përfundim të programeve të studimeve Institucioni i ka publike dhe disa prej tyre në faqen e internetit. Përveç kësaj studentëve ju jepen edhe broshura e cila përmban shumë përshkrime lidhur me student dhe studime.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion dhe takimet me studentë, ata ishin shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e akreditimit të programit.</p> <p>Ekziston Zyra e Karrierës (ZMSKK) e ngritur në Universitet e cila ju ndihmon studentëve me shërbime, këshilla lidhur me karrierën.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p style="text-align: center;"><b>N/A</b></p> <p>Studentët e parë të këtij programi studimi priten të diplomohen në fund të vitit akademik 2017-2018 dhe akreditimi zhvillohet për herë të parë.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>N/A</b></p> <p>Studentët e parë të këtij programi studimi priten të diplomohen në fund të vitit akademik 2017-2018 dhe akreditimi zhvillohet për herë të parë.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Të gjitha informacionet lidhur me studentët, programin e studimit, afatin e provimeve, afatin e përfundimit Institucioni i ka publike dhe disa prej tyre në faqen e internetit. Përveç kësaj studentëve ju jepen edhe broshura e cila përmban shumë përshkrime lidhur me student dhe studime.</p> <p>Suksesi i provimeve të mbajtura përkatësisht të përfunduara ju publikohet studentëve përmes platformës elektronike RASH e cila është në zbatim e sipër nga Institucioni. Në këtë platformë</p>

	<p>RASH (Rrjeti Akademik Shtetëror)</p> <p>Përgjegjësi i lëndës/modulit organizon pjesët e provimeve sipas kritereve të dhëna edhe në syllabus dhe ndër të tjera pjesa përfundimtare e provimit mund të organizohet me gojë dhe aty studenti e merr informatën për vlerësim.</p>
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni ka hierarki të organizimit të njësive akademike dhe udhëheqje të programeve të studimeve. Përmes personave përgjegjës të programeve studentëve ju ndihmohet në zgjidhje të çështjeve problematike lidhur me procesin mësimor, sikur mund të jenë literatura e jashtme, përkthimet eventuale etj.</p> <p>Ekziston Zyra e Karrierës (ZMSKK) e ngritur në Universitet e cila ju ndihmon studentëve me shërbime, këshilla lidhur me karrierën, si dhe me problemet me specifike sikur praktika profesionale, udhëzimet për praktike orientimet e studenteve. etj.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p><b>Konstatimi i GVJ lidhur me çështjet që lidhen me Studentët, që Universiteti POLIS, përkatësisht Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profilet Strukturë dhe Gjeoteknikë është se standardet e kërkuara plotësohen duke u mbështetur në faktet e gjetura gjatë vizitës në ambiente si dhe takimet me studentët si dhe Raportin e Vlerësimit të brendshëm. Cilësia e ofertës akademike nga Institucioni, permanent insistohet të rritet, ambientet e Fakultetit ofrojnë komoditet, raportet Profesor Studentë janë të niveleve shumë të kënaqshme, puna akademike me studentët pa ngarkesa të koncentruara dhe lehtësisht probleme të zgjidhshme.</b></p> <p><b>Mundësi e shfrytëzimit të programeve profesionale gjatë studimit sikur janë SAB, ETABS, CAD etj për të cilat studenti ka nevojë të madhe për zotim.</b></p> <p><b>Problemi i cili është identifikuar si mungesë e Institucionit mund të numërohet mungesa e laboratorëve të materialeve dhe strukturave. Universiteti ka arritur që të bëjë marrëveshje me kompaninë private të prodhimit të produkteve ndërtimore "PESPA" për bashkëpunim dhe ndërtimin e një laboratorit për shqyrtimin e strukturave të lehta.</b></p>	


## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

Misioni i Universitetit POLIS është, sigurimi i “Njohurive, Teknologjisë dhe Lidhshërisë”. Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe të aplikuar, Institucioni zhvillon e promovon “ekselencën shkencore dhe inovacionin”, ku edukimi akademik, përmirëson kompetencën kreative dhe gjithëpërfshirëse.

Përsosja e “Fokusit Kërkimor” dhe promovimi i “Bashkëpunimit Ndërdisciplinor” në njësitë kërkimore dhe akademike, stimulon “Sinergjinë e Inovacionit” ndërmjet shkëmbimeve Ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve si:

- Sicily\_LAB një eksperiment i ndërthurur me NITRO SAGGIO - New Information Technology Research Office, një skuadër kërkimore në Romë, Itali;
- Make\_LAB, laborator kërkimor pranë LawrenceTech, Detroit/USA;
- Programe Master në bashkëpunim me Universitetin Erasmus/IHS Institute Rotterdam/Holland, TU Vienna/Austria, dhe Ferrara University/Itali.

Implementimi i njohurive të marra në projekte konkrete nga kërkimi i vazhdueshëm shkencor dhe puna akademike e Institucionit tregojnë rezultatet e arritura duke prezantuar disa nga projektet e mëposhtme.

**Konsulence:** Konkurs Ndërkombëtar, Europian 2011. Pejë Kosovë; Periudha: 2011; Ishulli i Osumit në Berat: konkurs ndërkombëtar i projektimit urban. Periudha: 2015; Plani i Përdorimit të Tokës, Bashkia Shkodër. Periudha: 2016-2017 etj.

Bashkëpunimet bilaterale Projektet: Down to Earth: Earthen Architecture in Eastern Europe, Periudha: 2015-2016; NUFFIC, Periudha: 2013-2014; Western Balkan-From Historical Integration to Contemporary Active Participation, Periudha: 2012-2014; etj

Projektet **TEMPUS** ne dekadën e fundit të gjetura ne Institucion: Tempus IV (2008): Tempus IV ishte e inicuar të mbuloj vitet 2007 – 2013

Institucioni ka marrë pjesë edhe në dy projekte të TEMPUS dhe mund të konsiderohet se i vetmi institucion vendor që udhëheq projekt të financuar nga BE.

Project Title: Developing and Adapting Professional Programs for Energy Efficiency in the Western Balkans, Period: 2013 - 2016

Project Title: Connecting Science-Society Collaborations for Sustainability Innovations, Period: 2013 - 2016

**Horizon 2020** Është një program i madh i Inovacionit dhe hulumtimeve të mundshme për 7 vitet prej (2014-2020). Ky program premtan përparime të shumta, zbulime të para në bote duke marrë idete e medha nga eksperimentet në treg.

Në të gjitha projektet e kaluara dhe projektet e reja, Institucioni merr pjesë përmes mësimdhënësve të angazhuar në procesin mësimor si dhe studentëve.

Departamenti Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka organizuar konferenca ndërkombëtare kurse formimi, (<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/53>). Ndërsa konferencat e organizuara janë sikur në vazhdim:

- ✓ Konferenca Europiane e Gjeo-Mjedisit dhe Ndërtimit
- ✓ Konferenca ndërkombëtare mbi “Rrëshqitjet e tokës dhe gjeomjedisit – Simpozium ndërkombëtar në rajonin e Ballkanit.
- ✓ International Conference: Landslides and Geo-Environment - Geotechnical Symposium in the Balkan Region.
- ✓ Organizimi i kursit të formimit me temë: “Futja e teknologjive të reja në projektimin dhe nërtimin e veprave të ndryshme”.
- ✓ Në Shtator 2017, në datat 4, 5, dhe 6, në Tiranë u organizua një nga ngjarjet më të mëdha në fushën e strehimit – konferenca e Rrjetit Europian të Studiuesve të Strehimit (ENHR)

Institucioni ka botimin e revistes periodike "Forum A+P" në të cilën revistë publikohen punime edhe të stafit të pedagogëve.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 11)



Tabela në vazhdim pasqyron shënimet e sintetizuara për kërkimet shkencore të stafit akademik të departamentit të angazhuar në Institucion.

Tabela 11

Individi/Departamenti	Botime	Konferenca	Doktoratura	Libra	Monografi	Projekte
Dr. Arben Shtylla	1	2	1 (udhëheqje)	1	-	3
Prof Dr Luljeta Bozo	5	4	5 (udhëheqje)	-	-	-
Dr. Llazar Kumaraku	2	1	(udhëheqje)	-		-
Dr. Saimir Kristo	5	2	1	1		3
Dr. Etleva Dobjani	2	2	1	-		1
Dr. Eglja Luca	3	2	1	2		3
Dr. Laura Pedata	1	3	1 ne proces	-		1
Ilda Rusi	-	3	-	-		11
<b>Departamenti</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>13</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>22</b>

**Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Institucionit 139

**Numri i projekteve kërkimore të fituara**

14 projekte kërkimore Europiane të fituara.

**Numri i projekteve të zbatuara**

14 projekte të zbatuara.

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Ka më shumë se 10 aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL.

**Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**

Numri i pjesëmarrësve 91.

**Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor:**

Rreth 370.

**Numri i Çmimeve Kombëtare**

Janë tre çmime ndërkombëtare:

- ✓ Studio më e mirë lokale për konkursin ndërkombëtar Vlora Waterfront
- ✓ Çmimi i Inovacionit për konkursin ndërkombëtar Tirana Northern Boulevard Extension në bashkëpunim me KCAP
- ✓ Çmimi i parë i konkursit “Vepro Tani” , organizuar nga ambasada Amerikane

Lidhur me kërkimet shkencore, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare Institucioni ka një background të pasur të tyre. Gjithashtu dhe personeli Akademik është kreativ dhe gjithmonë azhurnojnë, ndjekin dhe zbatojnë projekte të cilat lidhen me fushat e studimeve dhe mësimve.

Gjatë vizitës GVJ pati qasje te materialet e shumta të institucionit sikur botimet periodike të POLIS, përkthimet e librave për nevojat e studentëve sikur është libri Dinamika e Konstruksioneve.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar ne Institucion ka angazhime permanente edhe për kërkime shkencore të përcjellura me punime shkencore nëpër konferenca dhe gazeta si dhe në periodikun e Universitetit “Forum A+P” <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/49">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/49</a>.</p> <p>“Forum A+P” është njohur nga MASH dhe ISSN International Center (ISSN 2227-7994) si revistë shkencore dhe është pajisur me ISSN ndërkombëtare. Periodiku i cili botohet 3-4 herë në vit, është i pari i këtij lloji në territoret shqipfolëse dhe përbën në këtë mënyrë një eveniment profesional dhe kulturor. Revista është një platformë komunikimi dhe debati për gjithë profesionistët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi duke kontribuar në ngritjen e nivelit të debatit shkencor në këto disiplina në vend dhe në gjithë rajonin.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Janë disa lëndë të programit të studimit Master i Shkencave të Inxhinierisë së Ndërtimit për të cilat mësimi zhvillohet në gjuhë Angleze. Duke pas marrëveshje IAL me Institucionet partnere këta pedagogë janë të huaj dhe frekuentojnë varësisht nga nevoja e Institucionit.</p> <p>Në matricën e lëndëve për dy profilet dhe për dy gjeneratat nuk ka lëndë të veçantë për gjuhën Angleze. Ndërsa kusht për regjistrim në studime ishte njohja e gjuhës Angleze.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimit-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Janë identifikuar dhe zhvilluar një sërë trajnimesh “in house”, pra brenda institucionit por me partnerë të ndryshëm ndërkombëtare si cikli i trajnimeve MATRA në bashkëpunim me IHS/ Erasmus dhe mbështetur nga Qeveria Holandeze.</p> <p>IAL inkurajuar personelin akademik për të filluar ciklin e tretë të studimeve; kështu janë zhvilluar 2 programe MND ku pjesa dërmuese e pjesëmarrësve kanë qenë stafi brendshëm i universitetit, dhe aktualisht një pjesë e konsiderueshme e stafit janë në proces së kryerjes së</p>

	studimeve të Doktoraturës.
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni harton raportin vjetor të aktiviteteve të hartuara në fillim të vitit dhe cilëson realizueshmërinë e tyre.</p> <p>Institucioni ka bankën e shënimeve për botimet si dhe vet botimet të qasshme në bibliotekën e sajë.</p> <p>Projektet në të cilat merr pjesë Institucioni janë publike në faqen e internetit të Universitetit.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p><b>GVJ gjatë vizitës në Institucion, takimeve me Personelin Akademik, Administratën, Studentët, Stafin Menaxherial të Institucionit janë identifikuar punët e sistemuara të të gjithë pjesëmarrësve dhe se Objektivat dhe Misioni i Institutit përkon me programet e krijuara. Ndërsa pa ndalë Institucioni së bashku me Personelin dhe Studentët realizojnë punë kreative në fusha përkatëse. Kreativiteti i referohet përveç mësimdhënies edhe pjesës tjetër të punës dhe veçanërisht kërkimeve shkencore.</b></p> <p><b>Personeli Akademik ka përkushtim për nxënie të reja që lidhen me metodat e avancuara të ligjërimeve dhe publikimeve shkencore. Hetohet nga takimet me Studentët freskia e tyre dhe dëshira e madhe për studime më të thella në fushat e studimeve të Inxhinierisë së Ndërtimeve.</b></p> <p><b>Mundësia e publikimeve në periodiken "Forum A+P" është një shans i mirë për stafin akademik dhe jo vetëm, që të publikojnë punimet e tyre, të arriturat e tyre në fushat e veprimeve profesionale.</b></p> <p><b>Krahasimi i Raportit të Brendshëm me gjetjet në vend janë jashtëzakonisht të vogla dhe se puna institucionale është cilësore.</b></p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Nga vizitat inspektuese në institucion në U\_POLIS, rezultoi se ky institucion, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucion të arsimit të lartë (vendase dhe të huaja), shoqëri tregëtare private, institucione shtetërore si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur në mision e institucionit dhe realizimin e tij me nënshkrimin e marrëveshjeve të ndryshme me institucionet e llojit të lartpërmendur.

Konstatuam se POLIS është një institucion i karakterizuar me një dimension i spikatur ndërkombëtar, gjë që reflektohet në mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike, në shkëmbimin e studentëve dhe stafit me shumë institucione të tjera të huaja kryesisht me vende të BE.

Këto bashkëpunime variojnë nga partneritete afatgjata me të cilat POLIS, ofron programe të përbashkëta, por dhe në partnerë *ad-hoc* ku POLIS krijon marrëdhënie për projekte të përbashkëta, workshope, veprimtari kërkimore dhe skema të ndryshme për mobilizimin e personelit akademik administrative por dhe të studentëve padysim.

Disa nga projektet e fituara dhe aktivitetet akademike të zhvilluara në lidhje me fushën e inxhinierisë së ndërtimit:

- “Knowledge Exchange in Planning: Research, Mobility, Creativity, Innovation” AESOP conference 2011-about 300 participants;
- International Symposium on Geo-slides 2011-about 120 participants; “[Re] Appropriation of the City” Conference, Tirana Architecture week 2012 -50 speakers/ about 300 participants;
- “Balkan Alternative Design” Conference, Tirana Design week 2013- over 300 participants;
- “Envisioning Future Cities” Conference, Tirana Architecture Week 2014-about 300 participants;
- “Design Now”, Tirana Design week 2015- over 300 participants;
- “Geo-Environment and Construction” European Conference 2015- <http://www.universitetiPOLIS.edu.al/?q=en/node/1114> -about 150 participants;
- “First Energy Efficiency Summer School”, 2016 ([https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/SECRETARIAT/Summer\\_School/2016](https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/SECRETARIAT/Summer_School/2016))- 40 students from region and Europe and over 20 academic an expert, one week activities
- “Final Conference of TEMPUS Project/ DAPEEWB”, 2016 ([www.eewb.org](http://www.eewb.org))-over 100 participants;
- “ENHR Conference- Tirana 2017”, 2017 (<http://www.enhr2017.com/>)- over 350 participants;
- “Empowering inclusivity “- Tirana Design week, 2017 (<http://www.tiranadesignweek.com/>)

Gjithashtu vazhdon implementimi i disa projekteve të tjera si:

1. Projekti Horizon 2020/ «Kultura e trafikut të sigurt dhe qasja drejt sistemeve të sigurta nëpërmjet ndryshimit në kulturën e kërkimit dhe inovacionit/ TraSaCu»
2. Projekti COST CA16114 «Rikonceptimi i qëndrueshmërisë nëpërmjet ekonomive regenerative» (RESTORE)
3. Future Architecture Platform – Projekt i financuar nga programi i BE «Evropa Kreative»
4. Erasmus KA 1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentë mes Universitetit POLIS dhe Universitetit te Minho-s Portugali
5. Erasmus KA 1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentë mes Universitetit POLIS dhe Universitetit Politeknik të Barit, Itali
6. Erasmus KA 1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentët mes Universitetit POLIS dhe Universitetit te Molise, Itali

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 12, Aneks).

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion konkludojmë se POLIS, është shumë i angazhuar në integrimin e aspekteve të formimit teorik, me atë kërkimor dhe praktik.</p> <p>Për këtë arsye janë ndërtuar marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organizma të ndryshëm publik dhe privatë.</p> <p>Sikurse është përmendur edhe më lart kurrikula e programit është konceptuar duke u bazuar në</p>

<p>publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>informacionin e grumbulluar nga tregu i punës, kompanitë e ndryshme si dhe studimet e tjera çka është menduar për një program me fokus konkret, integrim në tregun e punës.</p> <p>Ende nuk ka studentë të diplomuar por vlen të theksohet se bazuar në eksperiencën e POLIS, me programet e tjera për studentet e diplomuar ka një vëmendje të veçantë për ndjekjen e ecurisë së studenteve pas diplomimit, për programin në fjalë për të parë se si njohuritë e marra do të ndihmojnë studentet në jetën e punës për zgjedhjen e problemeve dhe realizimin e arritjeve që ata kanë planifikuar.</p>
--	--

**Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Gjatë vizitës u vu re se kishte një frymë të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit midis anëtareve të stafit në nivel departamenti ashtu dhe institucional. Kjo bënte të inkurajohej nisma për projekte të përbashkëta midis stafit, publikimeve të ndryshme si dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore por dhe duke u kujdesur për një jete më të pasur sociale që kuron marrëdhënie të mira personale midis tyre.</p>
--	--

**Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**


<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti disponon një numër të madhë marrëveshjesh me universitete të rajonit por dhe më gjerë.</p> <p>U_POLIS, ka një rrjet të zgjeruar të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtare të përzgjedhur në përputhje me strategjinë e institucionit. Ky rrjet pasurohet vazhdimisht në mënyrë që institucionet dhe llojet e partneritetit të ndihmojnë në arritjen e objektivave të institucionit.</p> <p>U_POLIS ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës në varësi të programit të studimit.</p> <p>U_POLIS bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe institucionet publike për organizimin e seancave dëgjimore, konferencave apo trajnimeve të përbashkëta.</p> <p>Universiteti realizon një raport analitik për të parë dhe kuptuar përfitimin e marrëveshjeve kontraktuale në funksion të realizimit të programeve.</p>
---	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

**Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas dhe të huaj, për kryerjen e praktikave të studentëve të tij. POLIS ka shfrytëzuar më së miri bashkëpunimet me aktorë të biznesit si për marrje përvoja, këmbim stafi, shkëmbim eksperiencash, përfitim të studentëve me praktika profesionale, njohja e funksionimit të kantierit, praktika lëndore, laboratorë specifike etj. Këtu mund të përmendet ALTEA, dhe së fundmi marrëveshja me PESPA-n.**

**Institucioni ka arritur të anëtarësohet në një nga organizatat më të rëndësishme të Inxhinierisë së Ndërtimit EUCET. Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi në mes personelit të tij. Në filozofinë e institucionit standardi për bashkëpunimin me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj është shprehur shumë qartë në Strategjinë e Zhvillimit të POLIS. Jo vetëm përfshirja por dhe pjesëmarrja e stafit në shumë evente kombëtare dhe ndërkombëtare sikurse janë, konferencat, simpoziumet, workshop-et bëjnë të mundur rritjen e dimensionit ndërkombëtar të institucioni dhe rrjedhimisht të programit në fjalë.**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardet e kapitullit të njëmbëdhjetë “Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun” janë plotësuar.**





## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

### **a. Pika të forta:**

- 1) Numri i lartë i kompanive, institucioneve me të cilat ka marrëveshje
- 2) Staf lokal dhe ndërkombëtar të kualifikuar dhe me eksperiencë praktike profesionale që jep dijet në mënyrë më të mirë të mundshme.
- 3) Struktura, përmbajtja e kurrikulës dhe programet lëndore/modulare janë në përputhje me kriteret shtetërore në këto programe, me modele kryesisht anglo-saksone, të përshtatura për mjedisin e kërkesat globale e lokale të tregut të punës
- 4) Kompetenca të mbushura dhe të kënaqshme në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit për Studentet pas diplomimit.

### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Mund të konsiderohet mungesa e Laboratorit për shqyrtimin e materialeve dhe konstruksioneve, mirëpo Institucioni të vazhdojë të konsolidojë ngritjen e Laboratorit për Testimin e materialeve dhe konstruksioneve, bazuar në marrëveshjen e realizuar me ESPA GROUP
- 2) Mungesa e titujve dhe botimeve bashkëkohore në gjuhën shqipe të botuara në fushën e inxhinierisë janë të pakta. Por U\_POLIS ka marrë përsipër ta mbushi këtë hendek me një sërë përkthimesh të disa prej titujve më të mirë në treg në fushën e inxhinierisë së ndërtimit.
- 3) Mungesa e lëndëve profesionale të fushave të profileve strukturë dhe gjeoteknikë mund të konsiderohet si çështje e cila do vëmendje më të shtuar për të ardhmen e programit me qëllim që të bëhet profili më atraktiv, gjithashtu edhe lëndet e Menaxhimit (menaxhim në ndërtim, menaxhim në projektim, organizimi i kantierit, organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve mbikëqyrëse për projektet sipas standardeve ndërkombëtare dhe Evropiane (FIDIC, PRAG, etj)).

### **c. Mundësitë:**

- 1) Të vazhdojë të ndjekë studentët edhe pas diplomimit të tyre në mënyrë që të evidentojë suksesin e kurrikulës.
- 2) Të vazhdojë të punësojë staf të përgatitur jo vetëm nga ana teorike, por edhe praktikë, si profesionistë inxhinieri me eksperiencë në terren sipas profileve të programit.

### **d. Pengesat:**

- 1) Tregu informal në fushën e ndërtimit i penalizon inxhinierët e rinj e të arsimuar
- 2) Vitet e pakta të programit, e bëjnë atë jo shumë të njohur në tregun aktual të sistemit të arsimit.

### **Rekomandime:**

1. Për të ardhmen rekomandohet që të veçohen Rezultatet e Nxënies (Learning Outcomes) nga Objektivat për secilën lëndë mësimore nga të cilat do të identifikoheshin kompetencat e profesionit.
2. Pas përfundimit të praktikës, Studenti fiton 6 ECTS dhe nuk vlerësohet me notë (6 ECTS nuk hynë në notën përfundimtare të studimeve). Sipas Bolonjës të gjitha lëndët/modulet (kreditë e fituara) duhet të jetë të vlerësuara me notë, prandaj Institucioni rekomandohet që praktikën profesionale të e vlerësoj me notë.
3. Rekomandojmë të zvogëlohen kreditet në grupin e lëndëve në D, duke ju dhënë studentëve hapësirë më të madhe në lëndë zgjedhore në semestrin e I të vitit të dytë, dhe në këtë rast do të duhej të zvogëlohen lëndët teorike nga 6 ECTS në 3 ECTS ndërsa të rritet numri i lëndëve - fushave profesionale dhe sidomos menaxhimit.
4. Rritja e lëndëve në gjuhën angleze për tërë programin e studimit do të ishte në favor të studentëve për plasimin e tyre në tregun e punës Europian dhe Ndërkombëtar, pasi që ky program ka objektiv edhe tregun e Evropës.

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci

Dr. Endrit TUZI

## ANEKSI 1

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Fakultet

Fakulteti	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada
ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD)						
Departamenti Art dhe Dizajn	7	4	3	-	10	4
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri	8	5	13	3	21	8
Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn	7	3			7	3
	22	12	16	3	38	15

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

FAKULTETI ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD)						
<b>Departamenti Art dhe Dizajn</b>						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Gezim Qendro	Prof.As	1	Luiz Kacmoli	MND	Profesionist i lire
2	Sonia Jovic	Dr	2	Gjergji Poçi	MND	Profesionist i lire
3	Edi Hila	Prof.Dr	3	Xhoi Musliaka	Msc	Land Market
4	Dorina Arapi	Dr				
5	Agron Mesi	PhD				
6	Keti Hoxha	PhD ne proc				
7	Gerdi Papa	PhD ne proc				
FAKULTETI ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD)						
<b>Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri</b>						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Arben Shtylla	Dr. Doc	1	Ada Lusha	Msc	Co-Plan
2	Egla Luca	Dr	2	Ani Shtylla	Msc	Profesionist i lire
3	Luljeta Bozo	Prof. Dr	3	Artan Raca	Msc	Profesionist i lire
4	Saimir Kristo	Dr	4	Edlira Xhafaj	Msc	Co-Plan
5	Etleva Dobjani	Dr	5	Genci Xhillari	Msc	Perfaqesues Lokal
6	Laura Pedata	PhD ne proces	6	Gerti Delli	Msc	Co-Plan
7	Ilda Rusi	PhD ne proces	7	Krist Andoni	Msc	Profesionist i lire
8	Aguljen Marku	PhD ne proces	8	Kristaq Gjino	Prof.As	UT
			9	Ols Lafe	Dr	
			10	Renis Batalli	Msc	Profesionist i lire
			11	Silvi Jano	Msc	Co-Plan
			12	Stela Sefa	Dr	UAMD
			13	Xhevair Ngjeqari	Msc	Profesionist i lire
FAKULTETI ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD)						
<b>Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn</b>						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Thoma Thomai	Prof. Dr				
2	Ledian Bregasi	Dr				
3	James Stevens	Prof.As				
4	Gjergji Simaku	PhD proces				
5	Joan Konomi	Msc				
6	Mirva Gega	Msc				
7	Altin Sula	MP				

Tabelat 3: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për stafin akademik të programit të studimit

Stafi i angazhuar në programin e studimit gjatë vitit akademik 2016-2017						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Luljeta Bozo	Prof. Dr.	1	Silvana Sukaj	Dr	Pavaresia
2	Gjergj Konomi	Prof. Dr.	2	Zenel Bajrami	Msc	Co-Plan
3	Diana Haxhihseni	Prof. As. Dr	3	Gerti Delli	Msc	Co-Plan
4	Arben Shtylla	Dr. Doc.	4	Xhevahir Ngjeqari	Msc	Profesion i lire
5	Egla Luca	Dr				
6	Antonino Di Raimo	Dr				
7	Godiva Rembeci	Dr				
8	Loris Rossi	Dr				
9	Etleva Dobjani	Dr				
10	Manjola Hoxha					
11	Gerdi Papa	PhD proces				
12	Lorenc Islamaj	PhD proces				
13	Ersilio Tushaj	PhD proces				
	<b>Në total</b>	<b>13 PAE</b>		<b>4 PAK</b>		

\*) Që nga data: 02.05.2017 pedagogu Lorenc Islamaj u zëvendësua nga Dr. Doc. Merita Guri

Që nga data: 02.05.2017 pedagogu Ersilio Tushaj u zëvendësua nga PhD proces. Ilda Rusi

Stafi i angazhuar në programin e studimit gjatë vitit akademik 2017-2018						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Luljeta Bozo	Prof. Dr.	1	Zenel Bajrami	Msc	Co-Plan
2	Gjergj Konomi	Prof. Dr.	2	Gerti Delli	Msc	Co-Plan
3	Merita Guri	Dr Doc.	3	Xhevahir Ngjeqari	Msc	Profesion i lire
4	Arben Shtylla	Dr. Doc.	4	Miha Cebuj	Msc	I ftuar
5	Egla Luca	Dr				
6	Godiva Rembeci	Dr				
7	Loris Rossi	Dr				
8	Silvana Sukaj	Dr				
9	Etleva Dobjani	Dr				
10	Manjola Hoxha					
11	Gerdi Papa	PhD proces				
12	Ilda Rusi	PhD proces				
13	Aguljen Marku	PhD proces				
14	Mirva Gega	Msc				
	<b>Në total</b>	<b>14 PAE</b>		<b>4 PAK</b>		

Tabela 4 Stafi Akademik te programit studimor për profilet Strukture dhe Gjeoteknikë

Kualifikimi i Stafit Akademik për programin e studimit Strukture dhe Gjeoteknike						
Titulli	Viti 2016-2017			Viti 2017-2018		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesor	2	0	2/0	2	0	2/0
Profesor te asocuar	1	0	1/0	0	0	0/0
Doc /Dr	2	0	2/0	2	0	2/0
Doktor	6	1	6/1	6	0	6/0
PhD ne proces	4	0	4/0	3	0	3/0
Asistent MA	0	3	0/3	1	4	1/4
Personeli Administrativ	10	0	10/0	10	0	10/0

Tabela 5 Stafë Akademik sipas seksit

Stafë Akademik për programin e studimit Struktura dhe Gjeoteknike						
Titulli	Viti 2016-2017			Viti 2017-2018		
	Femra	Meshkuj	Raporti F/M	Femra	Meshkuj	Raporti F/M
Profesor	1	1	1/1	1	1	1/1
Profesor te asocuar	1	0	1/0	0	0	0/0
Doc/Dr	1	1	1/1	1	1	1/1
Doktor	5	1	5/1	5	1	5/1
PhD ne proces	1	2	1/2	1	2	1/2
Asistent MA	0	3	0/3	1	4	1/4

Tabela 6 - Stafë Akademik dhe Administrativ gjatë vitit akademik 2017/2018

	Numri i PAE në moshë					Numri i PAK në moshë				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesor					2					
Profesor asocuar										
Profesor asistent			1	1						
Doktorant	2	3	1							
PhD ne proces	3									
Asistent MA	1					3			1	
Administrata	3	3	4							

Tabela 8

Mjediset për Universitetin POLIS	Sasia	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup> /për student
Salla për leksione / studio	9	1062	Hapësira për aktivitetin akademik 3.4 m <sup>2</sup>
Klasa për seminare / studio (+ laboratorët CAD LAB + 3D LAB)	8	587	
Salla për aktivitete promovuese/ konferenca	1	216	
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	2	288	
Laboratorë për lëndët	2	180	
Laboratorë informatike	2	145	
Salla interneti	1 (+ WiFi)	240	Hapësira sekondare për aktivitetin akademik 2.3 m <sup>2</sup>
Salla për bibliotekë	1	155	
Mjedis për fotokopjime, librari, arkiva, etj	3	111	
Zyrë informacioni për studentët	1	10	
Korridore/holle	4	1172	
Mjedise sportive	1	1000	Hapësira për aktivitete rekreative dhe shërbime 2.9 m <sup>2</sup>
Mjedise shërbimi për të tretë (Co-Plan; Metro_POLIS)	2	227	
Nyje hidrosanitare për studentët	34	238	
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	6	40	
Nyje hidrosanitare për personat me aftësi të kufizuar	4	25	
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fastfood/ restorant	1	563	
<b>Totali për studentët</b>	<b>92 ambiente</b>	<b>6259 m<sup>2</sup></b>	<b>8.6 m<sup>2</sup>/ student</b>
<b>Mjediset për stafin:</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>	<b>m<sup>2</sup>/për person</b>
Zyrë për Rektorin/Dekanin/zv dekanin	4	126	15.8 m <sup>2</sup>
Zyrë për zv.rektorin	1	16	16 m <sup>2</sup>

Zyra për sekretarinë mësimore	1	47	9.4 m <sup>2</sup>
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	2	62	4.4 m <sup>2</sup>
Zyra për personelin akademik	2	100	4.2 m <sup>2</sup>
Zyrë për financën	1	25	6.3 m <sup>2</sup>
Zyrë për njësinë e Bnj / juridike / protokollin	1	25	8.3 m <sup>2</sup>
Salla për mbledhje	2	30	2.5 m <sup>2</sup>
Mjedis për stafin e shërbimit (IT/mirembajtje)	4	89	6.9 m <sup>2</sup>
<b>Totali për staf</b>	<b>16</b>	<b>520 m<sup>2</sup></b>	<b>6.2 m<sup>2</sup> / person</b>

Tabela 9: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Nr.	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në NJSBC
1	Manjola Hoxha	Kryetar	2015
2	Edmond Agolli	Anëtar	2015
3	Vera Bushati	Anëtar	2015
4	Etleva Dobjani	Anëtar	2009
5	Silvana Sukaj	Anëtar	2017
6	Alketa Sula	Anëtar	2006
7	Xhoana Kristo	Anëtar (Përfaqësues i studentëve)	2017
8	Gjergji Dushniku	Anëtar (Përfaqësues Alumni)	2017

Tabela 11

Projektet Bi/Multilaterale					
1	Programi TEMPUS/ Projekti DAPEEWB (Koordinator Universitetit POLIS) : “Zhvillimi dhe Përshtatja e Programeve Profesionale mbi Eficiencën Energjitime në Ballkanin Perëndimor”	Kosove, Mal i Zi, Gjermani, Hollande, Sllovaki, Portugali	Dhjetor 2013	3 vite	Qëllimi i projektit është të kontribuojë në modernizimin e arsimit të lartë në vendet partnere të Evropës juglindore, si Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi si dhe të adresojë nevojat e tregut duke aftësuar profesionistë në fushën e eficiencës së energjisë
2	Programi TEMPUS/ Projekti CONSUS (Koordinator Karl- Franzens-University of Graz, Austria)	Kosove, Austri, Irlande, Gjermani	Dhjetor 2013	3 vite	Qëllimi i këtij projekti, duke iu drejtuar prioritetëve rajonale të Ballkanit Perëndimor, është të krijojë një rrjet rajonal ‘Shkencë (ku përfshihet arsimiti i lartë dhe kërkimi)-Shoqëri’ (ku përfshihet praktika) për inovacione të qëndrueshmërisë në Shqipëri dhe Kosovë.
3	H2020-MSCA-RISE/ Projekti KURATORIUM FUER VERKEHRSSICHERHEIT - Austria	Kosove, Austri, SHBA, Greqi, Estoni, Truqi, Finlande, Hollande	Prill 2014	Shkurt 2018	TraSaku është një projekt në Programin e BE Horizon 2020, MSCA-RISE, që synon zhvillimin e një qasjeje kulturore në sigurinë e rrugës dhe në parandalimin e aksidentëve.
4	Erasmus+ Programme, KA2/ QAINAL	Austri, Itali, Rumani, Kosove	2015	2018	Qëllimi i gjerë i projektit është të krijojë dhe të mbështesë proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhment efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxëniet në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri



5	Lifelong Learning Programme/ OIKONET A Global Multidisciplinary Network on Housing Research and Learning/ Koordinator: La Salle School of Architecture Barcelona, Spain	Spanje, Itali, Gjermani, Belgjike, Qipro, France, Irlandë, Turqi, Serbi, Suedi, Slloveni	2013	2016	Qëllimi i projektit është krijimi i një platforme bashkëpunimi mbi studimin e të banuarit bashkëkohor
6	Creative Europe/Culture Sub-Programme/Platforms/ Koordinator: Museum of Architecture and Design – Ljubljana, Slloveni	Hollande, Slloveni, Serbi	2013	2017	Krijimi i nje platforme ku çdo vit nga artiste/arkitekt dhe profesioniste do prezantojnë idetë përmes leksioneve, workshopeve apo ekspozitave në shtetet partnere të kësaj platforme
7	AKTI Bilateral Agreement Between Albania and Austria/ Koordinator: Technical U Down to Earth: Earthen Architecture in Eastern Europe niversity of Vienna; Titulli: Down to Earth: Earthen Architecture in Eastern Europe	Austri	2013	2016	Projekt qe ne thelb kishte studimin për banesat me qerpiq ne Shqipëri dhe Austri
8	Erasmus+ KA2 “Graduates Advancement and Development of University capacities in Albania/ GRADUA”	Itali, Spanje	2017 (2018)	2020	Projekti strukturor pritet të filloje brenda 2017 dhe ka si qellim zhvillimin e kapaciteteve të të diplomuarve në Shqipëri
9	Erasmus+ KA107	Hollande/ Erasmus Universit, Rotterdam, The Netherlands	2015	2017	Shkëmbime stafi dhe studentesh
10	Erasmus+ KA107	France/ Ipag Business School, Paris, France	2015	2017	Shkëmbime stafi dhe studentesh
11	Erasmus + KA107	Latvia/ Building College Riga, Latvia	2015	2017	Shkëmbime stafi dhe studentesh
12	Erasmus + KA107	Portugali/ University of Minho	2016	2018	Shkëmbime stafi dhe studentesh
13	Erasmus + KA107	Itali/ University of Molise	2017	2018	Shkëmbime stafi dhe studentesh
14	Erasmus + KA107	Polytechnic University of Bari	2017	2018	Shkëmbime stafi dhe studentesh

Tabela 12

<b>Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</b>	
<b>1. Institucionet e Arsimit të Lartë</b>	<b>Lloji i bashkëpunimit</b>
Universiteti Ferrara, Itali	Program i përbashkët doktorature që lëshon Diplomë të Dyfishtë
IHS/ Erasmus University, Rotterdam, Hollandë	Programe master që ofrohen bashkarisht
Lawrence Technological University, Detroit, SHBA	Mobiliteti i krediteve në nivel master Shkëmbim studentësh dhe personeli
IPAG Business School, Paris, Francë	Program MBA i përbashkët
Sapienza University of Rome, Itali	Shkëmbim personeli
University of Graz, Austri	Programi CONSUS Tempus
Royal Academy of Art, Hagë, Hollandë	Workshop i përbashkët
Anhalt University of Applied Sciences, Dessau, Gjermani	Projekt i përbashkët i financuar nga DAAD
FH Mainz, Gjermani	Projekt i përbashkët i i financuar nga DAAD
TU Wien, Austri	Projekti "Down to Earth" Workshope të përbashkëta Shkëmbim personeli dhe studentësh
Universita IAUUV, Venecia, Itali	Dhurime librash për Biblio_POLIS
TU Darmstadt, Gjermani	Shkëmbim personeli
University of Studies, Trieste, Itali	Workshop i përbashkët
Universiteti i Tiranës	Konferencë e përbashkët
Akademia e Filmit "Marubi"	Bashkëpunimi nën kuadrin e Festivalit të Filmave për të Drejtat e Njeriut
University of Salerno, Itali	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
University of Minho, Portugali	Partnerët në projektin Erasmus Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Academy of Fine Arts, Katania, Itali	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Riga Building College, Latvia	Erasmus+, programi KA1
University of Bari "Aldo Moro"	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
University of Chieti-Pescara "G. d'Annunzio"	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
<b>2. Institucionet qeveritare</b>	<b>Lloji i bashkëpunimit</b>
Akademia e Shkencave	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Arkiva e Ndertimit Teknik Qendror	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Ministria e Inetrgimit European	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Ministria e Punës dhe Mundësive të Barabarta	Bursa për studentët romë
Ministria e Turizmit, Kulturisë, Rinisë dhe Sporteve	Projekt për arkivin dhe muzeun e realizmit socialist në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare dhe Galerinë e Arteve
Ministria e Mbrojtjes	Projekt për transformimin e bunkereve
Bashkia Tirane	Java e Arkitekturës në Tiranë – TAË Workshopi Toponim në Tiranë Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Ambasada Amerikane	Projekti "Vepro Tani"
Ambasada Gjermane	Ekspozita "I.C.O.N.S"
Ambasada Zvicerane	Ekspozita e Pozicioneve Zvicerane
Ambasada Austriake/Shoqeria Austriake Shqiperi	Një konferencë e përbashkët
Agjencia e Zhvillimit Austriak	Festivali i Filmit për Mjedisin
Bashkia e Tetovës	Vizioni për zhvillimin e qytetit
Instituti i Monumenteve Kulturore	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Komuna Kashar	Përgatitja e Guidës Kashar
Bashkia e Sarandës	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Bashkia Burrel	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Deutschzentrum	Bursë për Workshopin Kopshtaria Urbane
Bashkia Kamëz	Praktikë Profesionale
Bashkia Vorë	Praktikë Profesionale

<b>3. Organizata Profesionale</b>	<b>Lloji i bashkëpunimit</b>
Co-PLAN	Kërkime Shkencore dhe të Aplikuara
Metro_POLIS	Kërkime Shkencore dhe të Aplikuara
Bordi Austriak i Sigurisë Rrugore	Projekti Horizon 2020 - TraSaCu
ASIG – Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeo-Hapësinor	Shkëmbimi i Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike
Agjencia për Promovimin e kërkimit Europë - APRE	Konsorciumi i Infrastrukturës Kërkimore për Horizon 2020 – Projekti RICH
Trashëgimia Kulturore pa Kufinj	Workshope Restaurimi të Përbashkëta - Gjyrokstra
Fondacioni i Trashëgimisë Shqiptare	Workshope Restaurimi të Përbashkëta - Voskopoja
Bienali Ndërkombëtar i Artit Bashkëkohor në Tiranë	Episodi i parë – Bionalja Tiranë 2009
Inxhinierët pa kufinj, Bari	Workshop i përbashkët
URI / Bells	Konferencë e përbashkët në Ditën e Tokës
Hanss Seidel Stiftung	Konferencat
AËR, Rome, Italy	Konkursi për Stacionin Multimedial në Tiranë
Zeta Gallery	Ekspozita "I.C.O.N.S"
Altea & Geostudio 2000	Vizita studimore dhe punë laboratorike
GeoConsulting Albania	Vizita studimore dhe punë laboratorike
<b>4. Komuniteti i Biznesit, Tregu i Punës</b>	<b>Lloji i Bashkëpunimit</b>
Unioni Shqiptari Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve_AUA	Përfaqësimi i interesave profesionale
Tirana Business Park	Bursë për Fituesit e Konkursit Tirana Wayfinding
Alba Road (IZOTERM)	Praktikë Profesionale
REHAU	Praktikë Profesionale
Pestan Doo	Praktikë Profesionale
KNAUF	Praktikë Profesionale
Megatek	Praktikë Profesionale
ALUFLOR Construction Group	Praktikë Profesionale
P.T. Construction	Praktikë Profesionale
KIKA Construction	Praktikë Profesionale
GURI Sh.P.K	Praktikë Profesionale
EVEREST Group	Praktikë Profesionale
ALUMIL Group	Praktikë Profesionale
Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë	Praktikë Profesionale
Eksperienca Shqiptare	Praktikë Profesionale
Agjencia e Pasurive të Paluajtshme INF-93	Praktikë Profesionale
<b>5. Anëtarësime</b>	<b>Lloji i Bashkëpunimit</b>
EUCEET - European Civil Engineering Education and Training Association	Anëtarësi e Plotë
Shoqata e Shkollave Europiane të Planifikimit - AESOP	Anëtarësi e Plotë
Shoqata Europiane për Arsim në Arkitekturë - EAAE	Anëtarësi e Plotë
Këshilli European i Shkollave të Arkitekturës së Peisazhit - ECLAS	Anëtarësi e Plotë
Magna Charta Universitatum, Bolonja	Nënshkrues
Programi i Shkëmbimit të Europës Qendrore për Studime Universitare - CEEPUS	Anëtarësi e Plotë